

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com
Viti XXIV - Nr. 7713 E diel 18 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)



Opinion *i* **Ditës**
Kam pasur gjithmonë kënaqësinë të futem në një panair librash, pasi më është dukur vetja si në një festë dhe sikur takohem me Tolstoin, Kazanqazisin ...
Vijon në faqen 11

Nga SULEJMAN MATO
Panairi i ri i librit, ose "Panairi i përkthimeve"


Opinion *i* **Ditës**
Ambasadori Donald Lu ka një histori të gjatë e polarizuese në Shqipëri. Gjatë tri viteve si i dërguari i SHBA në Tiranë, ai promovoi aktivisht një ...
Vijon në faqen 21

Nga TODD WOOD
Vetingu i Lu, njerëzit e Soros në gjykata




EMRAT/ Dokumentet që mungojnë në çdo dosje

Lista e re, 5700 të përndjekurit që marrin paratë e dëmshpërblimit

Ministria e Financave publikon listën e trashëgimtarëve që përfitojnë këstin e tretë

Rreth 5700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërblim ...

Në faqen 8-10

POLICIA BLINDON QYTETIN PAS ATENTATIT ME GRANATE KU U PLAGOS 32-VJEÇARI

FNSH MESYN NE ELBASAN, KAPEN ARME DHE MINA

Kontrolle në lagjen "Emin Matraxhiu" shoqërohen 2 persona nga fisi Çapja. 38-vjeçari tenton t'i ikë policisë. Sekuestrohen edhe municione



(Në foto) Aksioni i FNSH dhe në Elbasan

PD MODEL KONSERVATOR
Mbështetja britanike, Basha: Zgjedhja e deputetëve nga baza
Në faqen 2

PROTESTA
Banorët e Astirit: Tërhiqni fadromat, pronën do e mbrojmë me armë
Në faqen 3

TIRANA FESTON ÇLIRIMIN
Bashkëpunuan me fashizmin, Koçi: Pasardhësit të kërkojnë falje
Në faqen 4

MONITORIMI
PD: Qeveria detyron bizneset të ndërrojnë kasat. Ahmetaj: S'ka VKM
Në faqen 5

NDESHJA NE SHKODER



Shqipëria mundet 0 - 4 nga Skocia, Panuçi: E vuaj
Në faqen 22



Fakte të reja mbi botimet e para publicistike. Gazeta "Iskodra" për herë të parë në vitin 1868

Zbulohet gazeta e parë e Shqipërisë

Mithat Frashëri dhe Ismail Kadare për kombin shqiptar: Nga një veprimtar në tjetrin

NGA ILIRJAN AGOLLI
Shkrimi sjell fakte të reja mbi botimet e para publicistike në Shqipëri. Falë historianëve turq, publiku ynë mëson se gazeta "Iskodra" ka dalë në dritë 11 vjet më parë nga ç'e dinë deri sot bibliografët e shtypit shqiptar. Pra,



"Iskodra" doli për herë të parë më 1868 dhe ridoli më 1879. Nga kjo shtyrje date me plot 11 vjet në thellësi të kohës, gazeta "Iskodra" bëhet e para gazetë e botuar në territoret shqiptare, duke lënë pas gazetën "Prizreni", e cila doli në dritë në gusht 1871 ...

Suplement

ZGJEDHJET PROCESI

PD model konservator britanik në përzgjedhjen e kandidatëve në zgjedhje

Valentina Madani

Mbështetja britanike, Basha: Zgjedhja e deputetëve nga baza "S'do lejojmë të inkriminuarit në Kuvend"

Partia Konservatore britanike, do të ofrojë modelin e përzgjedhjes së kandidatëve të Partisë Demokratike në zgjedhje. Kryetari demokrat Lulzim Basha zhvilloi dje një takim me dy anëtarë të Partisë Konservatore, David Jones dhe Matthew Wickers, të cilët e zhvillojnë këtë proces në Angli. Kjo është një frymë e re që lideri demokrat Basha kërkon të sjellë, gjithashtu, për të pas-truar parlamentin sipas tij nga persona që nuk kanë lidhje me njerëzit dhe rekordet kriminale. Tashmë, tha Basha po merrret përvoja më e mirë në kontinentin evropian, ajo e seleksionimit të kandidatëve përpara se ato t'i dërgohen për vlerësim dhe gjykim anëtarësisë, që është përvoja e Britanisë së Madhe, ajo e konservatorëve britanikë të kryeministres Theresa May. "Po marrim përvojën më të mirë në kontinentin evropian dhe në botë të seleksionimit të kandidatëve para se ato të dërgohen për vlerësim dhe gjykim anëtarësisë që është përvoja e Britanisë së Madhe, të Partisë Konservatore të Tereza May. Ndaj jam shumë i kënaqur që kërkesa është vlerësuar dhe në këtu kemi njeriun që kryeson procesin e përzgjedhjes së kandidatëve të parlamentit britanik", u shpreh z.Basha.



Kryetari demokrat Lulzim Basha

DEKLARATA

"PD po kontribuon në tri drejtime: dekriminalizimi, vetingu në politikë dhe reforma zgjedhore. Në kemi hedhur hapin konkret për ndryshimin statutor për seleksionimin e kandidatëve më pas t'i dërgohen për miratim anëtarësisë sipas Konservatorëve britanikë. Sot kemi këtu njeriun që kryeson procesin e përzgjedhjes së kandidatëve në parlamentin britanik", deklaroi z.Basha.



Banorët e Astirit gjatë protestës së djeshme

"Do rrëzojmë Ramën, opozita ngjall shpresë"

Kryemadhi i përgjigjet Metës: Nënshtrimi nuk është moderim

Lëvizja Socialiste për Integrim nisi turin e takimeve me strukturat e saj në gjithë Shqipërinë në përgatitje për zgjedhjet e 30 qershorit të vitit të ardhshëm. Kryetarja Monika Kryemadhi siguroi simpatizantët e LSI se opozita është e aftë të rrëzojë Edi Ramën dhe të ngjallë shpresë. Për kërkesën e Ilir Metës se LSI duhet të jetë më e moderuar, Kryemadhi u shpreh se nënshtrimi nuk është moderim. Monika Kryemadhi nga Shkodra nisi turin e takimit me strukturat e Lëvizjes Socialiste për Integrim, duke nisur kështu edhe rrugëtimin drejt zgjedhjeve lokale të qershorit 2019. Kryemadhi u tha shkodranëve se vendi ka ende



shpresë dhe se opozita e ka forcën për të rrëzuar Edi Ramën. "Shpresë ka. Nuk duhet të bëhemi vazhdimësi e propagandës së makinerisë së Edi Ramës, sepse është vetë ai që stimulon: Unë jam i keq, por jam më i miri nga të gjithë të këqinjët. Jo më të keq se Edi Rama nuk ka. Ne e kemi në dorë për ta larguar dhe rrëzuar Edi Ramën. E rrëzojmë edhe me votë, edhe me protestë. Si të na dojë qejfi

ne", deklaroi znj. Kryemadhi. Për sa i përket drejtim-it të LSI, Monika Kryemadhi nuk ngurroi t'i përgjigjej edhe Ilir Metës, i cili është shprehur se kjo forcë politike duhet të jetë më e moderuar. Për kryetaren e kësaj force politike kompromisi në dem të qytetarëve nuk është moderim. "Dje (të premtën) dëgjova Presidentin e Republikës që kërkonte që LSI duhet të moderohet pak. Më lejoni t'ju them se nënshtrimi nuk është moderim. LSI nuk do t'i nënshtrohet asnjëherë kujtdo kompromisi që bëhet në kurriz të shqiptarëve", u shpreh kryetarja e LSI. Sipas saj me Edi Ramën në krye të qeverisë, më shumë shqiptarë do të largohen nga vendi.

Partisë Socialiste. Basha i quajti ata përfaqësues të bandave dhe krimin të organizuar, sikurse edhe biznesmenë me kredenciale të dyshimta. "Sot demokracia shqiptare ndodhet në një krizë të thellë. Qytetarët shqiptarë shohin se parlamentin është mbushur me njerëz të cilët

nuk i përfaqësojnë, është mbushur me persona të cilët nuk kanë asnjë lidhje, shpeshherë as me partitë politike, të cilët i kanë kandiduar, e kam fjalën në veçanti për organizatën e "Rilindjes" në mesin e të cilës gjenden persona që kurrë nuk kanë qenë anëtar të PS, por janë

përfaqësues të bandave të krimin të organizuar, janë biznesmenë me kredenciale të dyshimta. Ky është problem shkatërrimtar për të sotmen dhe për të nesërmen e Shqipërisë. Dhe kjo duhet të ndalet, kjo duhet të marrë fund. Që të marrë fund Partia Demokratike po kon-

SHKURTE

Jones: Transparençë për përzgjedhjen e kandidatëve

Partia Demokratike do të ndjekë modelin konservator britanik në përzgjedhjen e kandidatëve të saj. Për këtë arsye, Kryetari i Bordit të Vlerësimit të Kandidaturave të Partisë Konservatore, David Jones, erdhi dje në Tiranë për të dhënë përvojën e konservatorëve në pushtet për mënyrën sesi përzgjedhjen kandidatëve përpara se ato të bëhen zyrtare. "Ne jemi këtu për të ndarë eksperiencën dhe punën tonë në Partinë Konservatore duke ofruar një sistem të hapur, demokratik dhe transparent për përzgjedhjen e kandidatëve për në parlament. Ne jemi të lumtur t'i ofrojmë këto eksperiencë dhe jemi të kënaqur me mikpritjen që na është dhënë dhe në veçanti për interesin që është treguar nga partia simotër këtu në Shqipëri", u shpreh David Jones për gazetaret.

LSI, Rama: Prishja e koalicionit nxori zbuluar PS-në

Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama u shpreh se prishja e koalicionit me Partinë Socialiste nxori zbuluar lidhjet e PS-së me krimin. Në një takim me strukturat e LSI-së në Shkodër, Luan Rama tha se nëse do të vijonin të ishin në qeveri me socialistët, Edi Rama do t'ia faturonte çdo të keqe LSI-së. Rama deklaroi se largimi i LSI-së nga qeveria, zbuloi lidhjet e qeverisë së Edi Ramës me krimin! Luan Rama zhvilloi një takim me strukturat e LSI Shkodër. "Nëse ne do të ishim në qeveri, natyrisht të gjitha këto dëshmi, fakte dhe realitete skandalozë të lidhjeve të krimin me politikën, kryeministri do t'ia faturonte LSI-së, siç bëri gjatë 4 viteve të shkuara", theksoi Luan Rama.

tribuon në dy drejtime së pari, përmes dekriminalizimit. Së dyti, përmes propozimit tonë përmes vetingut të politikanëve, dhe së treti përmes vetë reformës së partive politike dhe reformës zgjedhore", deklaroi z.Basha. Por kjo fazë para-përgatitore e huazimit të modelit britan-

ik në përzgjedhjen e kandidatëve vjen në një kohë kur demokratët nuk kanë përmbullur ende zgjedhjet e brendshme në parti, e kur reforma zgjedhore është bllokuar; ndonëse nga beteja elektorale me kundërshtarin në 30 qershor e ndajmë vetëm 7 muaj.



Veliaj: Në protestë asnjë banorë, s'ka shpronësim për lotot e lavazhet pa leje

Banorët e Astirit: Tërhiqni fadromat, pronën do e mbrojmë me armë

Protestuesit: Nga Unaza e Re do ju vijë fundi

Valentina Madani

Për 14 ditë me radhë, banorët e zonës së Astirit protestuan sërish dje kundër prishjes së banesave të tyre që preken nga projekti i Unazës së Madhe ndërsa paralajmëruan protesta pa afat deri në tërheqjen e fadromave nga pronat e tyre. Ata bllokuan rrugën tek Unaza e Re dhe kërkuan tërheqjen e fadromave. "Do të heqim gardhin rrethues dhe do të mbrojmë shtëpitë tona. Nesër në 11 do të bllokojmë rrugën pa afat nëse nuk na kthejnë përgjigje", shprehen ata. Protesta e tyre edhe mërzim u mbështet nga deputetët e Partisë Demokratike. Kërkesa e banorëve mbetet e njëjtë, dëmshpërblim 100% me vlerën e tregut për banesat. Banorët e Unazës së Re i bënë thirrje qeverisë dhe kryebashkiakut Erjon Veliaj, që t'i dëmshpërblejë për banesat dhe bizneset, në të kundërt do t'i mbrojnë me armë. "Shtëpitë tona nuk do i lëmë ashtu, gota është mbushur. Këtu do vdesim, unë për vete pronën time do ta mbroj me armë. Është një kushtetutë që e kanë shtete më demokratike. Pse shpellarë janë ata që protestuan në Francë sot? Ne po i vjedhim taksat apo ata po i vjedhin taksat?" - tha një prej banorëve. Ndërkohë një tjetër banor deklaroi se nëse shteti do t'i marrë shtëpinë dhe nuk do ta dëmshpërblejë, atëherë ajo do të zbatohet kanunin. "Unë shtëpinë time do ta mbroj sipas zonës nga vij, do ta mbroj me kanun me armë, deklaroj një tjetër banor. Nga Unaza e Re do t'ju vijë fundi, o Veliaj dhe Rama", theksoi një protestues. Ndërsa një grua denoncoi dhunën e ushtruar nga policia pasi i kishin shoqëruar djalin në komisarjat.



Protestat e djeshme te Unaza e Re

DEKLARATA

'Shtëpitë tona nuk do i lëmë ashtu, gota është mbushur. Këtu do vdesim, unë për vete pronën time do ta mbroj me armë. Është një kushtetutë që e kanë shtete më demokratike. Pse shpellarë janë ata që protestuan në Francë sot? Ne po i vjedhim taksat apo ata po i vjedhin taksat?' - tha një prej banorëve.

"Barbaria e fundit e një pushteti anarkistësh"

'Unaza e Re', Bujar Nishani: Fashistëve të rinj do t'iu vijë radha

Ish-Presidenti i Republikës Bujar Nishani reagoi dje me tone të forta ndaj projektit të qeverisë për shembjen e mbi 300 shtëpive në zonën e Unazës së Re. Z.Nishani foli dhe për shumë akte të tjera të qeverisë socialiste të Ramës, të cilat kanë cenuar rëndë Kushtetutën dhe ligjet e vendit, por edhe ligjet dhe parimet ndërkombëtare. Duke i përcaktuar si fashistët e rinj pushtetarët e sotëm, Nishani theksoi se "Shpejt do t'ju vij radha të gjitha këtyre dhunimeve të dalin në ditën e ballafaqimit me të drejtën dhe ligjin. Shpejtësinë e rendjes së kohës e kanë në dorë shqiptarët. Të gjithë, pa përjashtim". "Fashistët e rinj të vetëquajtur "antifashistë" pa asnjë procedurë ligjore, duke injoruar e dhunuar çdo parim e gërmë të Kushtetutës së Shqipërisë (Kapitulli i lirive dhe drejtave themelore) vendosin t'i marrin pa kundërshtim të drejtë shtëpitë e bizneset qindra familjeve", deklaroi ish-kreu i shtetit. Nishani kujton kohën kur si president tekta bënte betejën kundër "veprimeve antikushtetuese të qeverisë rilindëse për shumë ligje skandalozë të saj e midis të tjerash ligjin për pronat jam ndeshur me sulme dhe shpifje mjerane se gjoja isha i motivuar politikisht apo për interesa të konfliktit personal". Nishani paralajmëroi: "Shpejt do t'ju vijë radha të gjitha këtyre dhunimeve të dalin në ditën e ballafaqimit me të drejtën dhe ligjin. Shpejtësinë e rendjes së kohës e kanë në dorë shqiptarët. Të gjithë, pa përjashtim! Sot, jo vetëm familjet e Unazës së Re, por të gjithë Shqipërisë janë nën dilemën hamletjane: "të jenë apo të mos jenë"? Disa po ikin! Kjo nuk është e ardhmja më e mirë".



PARALAJMËRIMI
"Shpejt do t'ju vijë radha të gjitha këtyre dhunimeve të dalin në ditën e ballafaqimit me të drejtën dhe ligjin. Shpejtësinë e rendjes së kohës e kanë në dorë shqiptarët. Të gjithë, pa përjashtim", -tha Z.Nishani.

REAGIMI

Kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj iu kundërpërgjigjet dje akuzave të PD-së lidhur me protestën e banorëve tek Unaza e Re, të cilët kërkojnë dëmshpërblim për banesat që do t'u shemben. Nga Vaqarri, duke sqaruar se pronarët që preken nga Unaza e Madhe do të shpronësohen, kurse për ndërtimet pa leje do të ketë 3 vite bonus qiraje dhe banesa sociale, Veliaj sollti disa shembuj se si në ajo zonë është zaptuar nga lotot, la-

'Unaza e Re', Avokatja e Popullit: Projekti pa leje ndërtimi, banorët të sqarohen

Avokatja e Popullit Erinda Ballanca komentoi dje në emisionin "Kjo javë" në News24 protestën e banorëve të Astirit në kryeqytet, banesat e të cilëve preken nga projekti për 'Unazën e Re'. Avokatja e Popullit tha se qeveria dhe institucionet duhet të bëjnë publike detajet e projektit dhe të sqarojnë banorët, ndërsa sipas saj nuk ka ende një leje ndërtimi për projektin. "Nuk ka ende një leje ndërtimi për projektin. Institucionet të na thonë sa persona do preken nga ky projekt. Çfarë kostosh ka? Pra, ka disa pikëpyetje për këtë projekt dhe do ishte e udhës që të kishte një sqarim nga autoritetet dhe të mos e çojmë çështjen tek çështja: ka pasur banesa me leje apo pa leje. Është detyrë thelbësore për të mësuar nëse është zbatuar ligji apo jo. Ka qenë detyrë e qeverisë dhe organeve të tjera, të cilët duhet të kishin evidencuar se çfarë prone private do merrej në këtë projekt. Banorët kanë nevojë për përgjigje. Duhet të kishte një sqarim nga autoritetet. Ka shumë dispozita ligjore që janë shkelur në këtë projekt. Nuk ka asnjë veprim se cila do jetë rruga ligjore për dëmshpërblim. Është një situatë e ngjashme me rastin e Shkozës. Përrapa se të bëhet puna duhet të paguhet për pronën private. Këta persona që shkelin ligjin, asnjëherë nuk dënohen", tha Avokatja e Popullit.



vazhet, gomisteritë dhe "shtëpi" me 8 kate pa leje. "E kuptoj kur nga nevoja njeriu ndërton shtëpi për të jetuar, por 8 kate nuk është nevojtar, o miqtë e mi! Pse duhet t'ia marrë qeveria, bashkia lekët modeste të taksave dikujt në Vaqar dhe në vend që të bëjmë shkollën këtu, në vend që të bëjmë rrugën, duhet t'i japim lekë dikujt që thotë 'jam den baba den' në një shtëpi me 8 kate, ku qartazi as i ka mbaruar 8 kate? Protestuesi më i madh eurolotot! Po pse duhet njerëzit që s'luajnë baste të shpronësojnë një lotot?! Pse mos bëjmë një kopsht në Vaqar, po duhet të

Protesta tek Unaza e Re, Berisha nxjerr videon: Rama ndryshoi projektin

Ndërkohë që banorët e Astirit hyjnë sot në ditën e 15 të protestës kundër shembjes së banesave pa marrë më parë dëmshpërblim, ish-kryeministri Sali Berisha postoi një video denoncuese, sipas të cilës, punonjësit e bashkisë i ndërpresin energjinë bizneseve në zonën të Unaza e Re. Sipas tij, me porosi të Ramës është ndryshuar projekti dhe është rritur "gjerësia e unazës" nga 27m që ishte projekti i miratuar në 63 m, dhe trotuarin e njërës anë nga 11 në 33 m për të afruar rrugën afër ndërtimeve të trafikantëve dhe narko qeveritarëve".

tin kur në protestat e dhunshme para Bashkisë së Tiranës morën pjesë ish-efektivë të Gardës në ngjarjen e 21 janarit, të ardhur nga Burreli. "Shoh protestën për Unazën, s'kishte asnjë banor atje. Ishte gjithë FRPD dhe kryetari i PD-së së Burrelit, nga ata që ishin tek Garda në 21 janar, që vranë njerëzit me plumba në mish. Vjen nga Burreli, proteston për rrugën në Tiranë! Pyetja që unë kam për PD: S'ju ka mbetur asnjë simpatizant në Tiranë, që mund të protestojë? Duhet patjetër me i sjellë nga rrethet të tjera që të kundërshtoni punën në Tiranë?", theksoi z.Veliaj.

PË RVJETORI PROPOZIMI



PETRO KOÇI

"Ftoi të gjithë ata që janë pasardhës të atyre që bashkëpunuan me fashizmin t'i kërkojnë falje popullit, qytetarëve të Tiranës, se vetëm kështu mund të arrihet ai që quhet pajtim kombëtar. Lavdi të gjithë atyre që ranë dëshmor për çlirimin e vendit", tha zëvendësiministri i Mbrojtjes.



LUAN RAMA

"Le t'ia ndërrojnë edhe emrin monumentit, vepër e skulptorit Andrea Mano, e ta quajnë "Ballisti çlirimtar", në nderim të luftës së madhe dhe sakrificave të panumërta që Mid'hat Frashëri dhe ballistët e tij kanë bërë për çlirimin e Tiranës dhe të atdheut nga pushtuesit nazifashistët!" - shprehet z.Rama.

Tirana feston ditën e Çlirimit, LSI: "Partizanin çlirimtar" ta quajnë "Ballisti çlirimtar"

Bashkëpunuan me fashizmin, Koçi: Pasardhësit të kërkojnë falje

Rama: Ballistët, sakrificat për çlirimin e Tiranës

Valentina Madani

Tirana festoi dje 74-vjetorin e çlirimit të saj. Kryetari i bashkisë Erjon Veliaj, zv. ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi dhe shumë të tjerë bënë homazhe tek 'Ushtri i Panjohur'. Zv. ministri i Mbrojtjes e quajti me rëndësi të madhe kombëtare Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe u kërkoi pasardhësve të atyre që bashkëpunuan me fashizmin t'i kërkojnë falje popullit, qytetarëve të Tiranës, sepse vetëm kështu mund të arrihet ai që quhet pajtim kombëtar. "Çlirimi i kryeqytetit, 74 vjet më parë kishte një rëndësi të madhe kombëtare e strategjike. Edhe sot e kësaj dite rëndësia e kësaj lufte është shumë e rëndësishme. Është një gjykim dhe vlerësim politik i domosdoshëm. Populli shqiptar në Luftën e Dytë Botërore zgjodhi rrugën e duhur. Mori vendimin e duhur politik e ushtarak për t'iu bashkuar një koalicioni të madh antifashist me armë në dorë për të çliruar vendin. Kuptohet që jo të gjithë shqiptarët zgjodhën këtë rrugë. Ishin vetëm 70 mijë partizanë dhe partizane që u rreshtuan në Ushtrinë Nacional Çlirimtare kur të tjerët zg-



Zv. ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, dhe tek 'Ushtri i Panjohur'

jodhën rrugën tjetër. Ata donin që duke bashkëpunuar me fashizmin e nazizmin të mbanin pushtetin politik duke tradhatur interesat e vendit. Ata nuk luftuan për Shqipërinë e madhe, por të mërrnin pushtetin, por populli shqiptar nuk i mbështeti. Ai mbështeti 70 mijë partizanë çlirimtarë", deklaroi z.Koçi. Prandaj sipas tij kjo

ditë e Çlirimit të Tiranës është e rëndësishme ndërsa ftoi të gjithë ata që janë pasardhës të atyre që bashkëpunuan me fashizmin t'i kërkojnë falje popullit, qytetarëve të Tiranës se vetëm kështu mund të arrihet ai që quhet pajtim kombëtar. "Lavdi të gjithë atyre që ranë dëshmorë për çlirimin e vendit. Në emër të qeverisë dua të falënderoj Bashkinë e

Veliaj: Hera e parafundit që u dogjën goma para bashkisë, më 17 nëntor 1944

74-vjetori i Çlirimit të Tiranës u përkujtua dje nga të majtët. Kryebashkiaku Erjon Veliaj, përfaqësues të kështillit bashkiak dhe familjarë të të rënëve vendosën dje kurora me lule tek Ushtri i Panjohur. Veliaj bëri një paralelizëm të djegies së gomave, para Bashkisë së Tiranës dy ditë më parë me atë të 17 nëntorit 1944 nga pushtuesit nazifashistë. "Hera e parafundit që u dogjën goma në dorë të Bashkisë së Tiranës, ishte 17 nëntori i 1944, kur trupat që po largoheshin dogjën qytetin dhe shkretuan dëmet e fundit. Hera e fundit ishte pardje që u dogjën goma para Bashkisë së Tiranës. Pas 74 vitesh. Jo nga armiku, jo nga pushtuesi e zaptuesit, por nga ne vetë. Prandaj ky është moment reflektimi", theksoi z.Veliaj. Në fjalën e tij Veliaj gjeti rastin t'u kërkojë protestuesve të Astirit të reflektojnë dhe të mos bëhen pre e lojërave të politikanëve. "Sot nuk na rrezikon njeri. Gjasat që kush të na pushtojë, sabotojë janë shumë të vogla nga të huajt, por vetë mund ta bëjmë. Ne sot kemi në dorë të mirën e të keqen, ta shkatërrojmë dhe ta zbukurojmë Tiranën, t'i vëmë zjarrin apo ta modernizojmë", - tha Veliaj.

Tiranës që me lartësinë e duhur politike dhe atdhetare organizon çdo vit këtë ditë të shënuar", theksoi z.Koçi. **PROPOZIMI** Në 74 vjetorin e Çlirimit të Tiranës, nënkryetari i LSI-së, Luan Rama, propozoi që monumentin "Partizanin çlirimtar", aty ku vendosin lule pushtetarët ta quajnë "Ballisti çlirimtar". "Le t'ia ndër-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, dje në muzeun e Manastirit

NOSTALGIKËT

Pas përfundimit të ceremonisë së organizuar nga Bashkia Tiranë, me rastin e 74-vjetorit të Çlirimit të Tiranës, komunistët ashtu si çdo vit kryen homazhe tek monumenti 'Ushtri i Panjohur' në qendër të Tiranës me foton e diktatorit Enver Hoxha, yllin me pesë cepa dhe me grusht.

Tiranës, ku pranë Monumentit të Ushtrisë të Panjohur u kryen homazhe nga grupi këshilltarëve bashkiakë dhe deputetëve të LSI Tiranë. Kryetari grupit të këshilltarëve të LSI në Bashkinë e Tiranës, Elton Halimi, në një prononcim për mediat theksoi: "Sot, në këtë 74-vjetor të Çlirimit të Tiranës nga pushtuesit nazi-fashistë, ne përkulemi me nderim dhe mirënjohje për luftën heroike të të rinjve dhe të reja të brigadave partizane, që së bashku me ndihmën dhe përkrahjen e pakursyer të popullit të Tiranës, në 17 nëntor 1944 çliruan kryeqytetin e Shqipërisë! Kjo datë e shënuar, e memories më të mirë të kombit tonë, që e radhiti atë në anën e drejtë të historisë përkrah aleatëve, apelon si një shembull frymëzues, që ashtu si atëherë patriotët në luftë, edhe ne sot, të kemi në themel të vizionit tonë, vendimmarrjet më të drejta për të ofruar më shumë shërbime dhe të mira publike në interes të të gjithë qytetarëve, komunitetit dhe qytetit tonë të përbashkët. Duke u përkulur gjithmonë me respekt për të rënë e atyre ditëve, ne vlerësojmë përherë traditën tonë atdhetare dhe demokratike! Mirënjohje përjetë luftëtarëve të Lirisë!"

SHPALLJE ANKANDI
Datë 23.11.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandit e trette për pasurinë e paluajtshme të dorëzuesit Baftjar Alush Murto:

- "Trrali + Ndërtesë" me sipërfaqe trrali 300 m² dhe ndërtesë 81 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me volun nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shaltes, Sarandë.

Cmimi fillësar i ankandit të trette është në shumën 907 200 (nëntëqind e shtatë mijë e dyqind) lekë. Ankandit do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Shitje me Ankand te trette nga Studio Perbarimore L.D.C

-1. "Ndërtese", me sipërfaqe 600 m², me Nr. Pasurisë 495/15, Vulum 5, faqe 83, ndodhur në Zonen kadastrale 3426 me adresë në Tufinë, Tiranë. Regjistruar në Zyrën Vendore Regjistrimit Pasurive Paluajtshme Tiranë, **Cmimi fillësar për shitje është 2.116.800 lekë.**

Data e shpalljes: 30.10.2018
Data e zhvillimit: 03.11.2018 deri në orën 16:00

Ankandit zhvillohet në ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adresë Rruga "Mystym Shyrti" Vllë 81, kati 1 Tiranë.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimitit "BALIFF SERVICE E HOXHA" sh.p.k n'kjofton Shpalljen e Ankandit të I-të, për shitjen e pasurisë ULLISHTE, me sip.3.400 m², Zona Kadastrale: 1615

Numeri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier- Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Selfer Skraçi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandit i pasurisë fillon me çmimin fillësar në vlerën 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzet mijë) LEKË.

Ankandit do të zhvillohet më datë 21.11.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimitit "BALIFF SERVICE E HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.teléfono 042320227, email: elvlnh@hotmail.com.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, ndodhet në Manastir për të përkujtuar 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit. Kreu i shtetit është pritur nga dhjetëra shqiptarë nga Maqedonia dhe ministri i Kulturës së Maqedonisë, Asaf Ademi. Po ashtu mësohet se Meta ka vizituar shtëpinë muze ku i mbledh Kongresi i Manastirit, ndërsa shoqërohej nga dhjetëra shqiptarë. Në mënyrë simbolike, Presidenti Meta ka shpërndarë 110 abetare për fëmijët shqiptarë të Manastirit ndërsa uroi mbarë kombin për 110-vjetorin e Alfabetit të gjuhës shqipe. "Me shumë emocion rikthehem në Manastir. Të bëjmë gjithçka që kjo ndërtesë historike për shqiptarët të pasyrojë më së miri kontributin e patriotëve shqiptarë. Pa Kongresin e Manastirit do të kishte qenë e vështirë edhe shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Shqiptarët janë faktor progresist në shërbim të paqes,

Presidenti në Manastir, shpërndan 110 abetare

Meta: Mirënjohje të përjetshme përfaqësuesve të Rilindjes Kombëtare



Presidenti Ilir Meta

stabilitetit dhe integritetit të rajonit" - shprehet presidenti. Kreu i shtetit shqiptar postoi në 'Facebook', një foto brenda muzeut të Manastirit, ku shpreh mirënjohje të thellë për patriotët e mëdhenj shqiptarë. "Mirënjohje të përjetshme patriotëve, vep-

rimtarëve dhe përfaqësuesve më të spikatur të Rilindjes sonë Kombëtare, Gjergj Fishta, Mid'hat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Bajo Topulli, Shahin Kolonja, Gjergj Qiriaz, Grigor Cilka, Sotir Peci, Taqi Buda, Nyzhet bej Vrioni dhe Parashqevi



DEKLARATA

"Mirënjohje të përjetshme patriotëve, vepërtarëve dhe përfaqësuesve më të spikatur të Rilindjes sonë Kombëtare, Gjergj Fishta, Mid'hat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Bajo Topulli, Shahin Kolonja, Gjergj Qiriaz, Grigor Cilka, Sotir Peci, Taqi Buda, Nyzhet bej Vrioni dhe Parashqevi Qiriaz, të cilët i dhanë zgjidhje një problemi madhor të kulturës kombëtare, alfabetit të gjuhës shqipe. Lavdi të përjetshme Kongresit të Manastirit që i dha jetë alfabetit tonë dhe përjetësoi gjuhën shqipe", shprehet z.Meta.

Deputeti i PD: Projekti korruptiv për monitorimin e biznesit nuk duhet të zbatohet

PD: Qeveria detyron bizneset të ndërrojnë kasat. Ahmetaj: S'ka VKM

"Forcojmë kontrollet vetëm për hidrokarburet"

Demokratët përmes deputetit Endri Hasa kanë denoncuar atë që e konsiderojnë si vendim korruptiv të qeverisë, që ka një kosto prej 600-1.000 euro për çdo biznes, për shkak se ka nxjerrë një vendim që skualifikon kasat ekzistuese fiskale, duke i detyruar bizneset që të pajisen me kasa të tjera. Partia Demokratike shpreh se të gjitha bizneset duhet të ndërrojnë kasat fiskale pasi qeveria ka ndryshuar parametrat e tyre, dhe kasat ekzistuese dalin jashtë përdorimit pasi transmetojnë shitjet vetëm në fund të ditës, dhe jo për çdo shitje sikur kërkon vendimi i ri i qeverisë. Sipas deputetit të Partisë Demokratike qeveria ka miratuar një vendim, i cili sipas PD, detyron bizneset që t'i ndërrojnë kasat. "Ministri i korrupsionit, Arben Ahmetaj, mund të bëjë propagandë nga mëngjesi deri në darkë dhe të gënjëjë paturpësisht shqiptarët se kasat fiskale nuk do të ndryshojnë, por e vërteta është se pak ditë më parë qeveria ka miratuar një vendim që, praktikisht, skualifikon kasat ekzistuese", tha Hasa. Tashmë, nga një herë në ditë, bizneset - tha depu-

teti Hasa në komunikimin e tij, - do të detyrohen të transmetojnë çdo shitje në kohë reale, një funksion që kasat ekzistuese nuk e kanë. Ai përmendi se: "Aktualisht, kasat fiskale janë të programuara të transmetojnë të dhëna vetëm 1 herë në ditë, kur biznesi mbyll xhiron, por me VKM Nr. 651, qeveria ka ndryshuar karakteristikat teknike për pajisjet fiskale, duke futur si kriter shtesë - "transmetimin e çdo shitjeje në kohë reale në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve". Kërkesat e sistemit të ri detyrojnë çdo biznes që të heqë kasat dhe sistemet elektronike që ka sot, për të blerë pajisjet e reja që mundësojnë transmetim të çdo shitjeje në kohë reale. Kjo do të thotë se 15 milionë eurot e tenderit korruptiv me kompaninë e paracaktuar kroate, janë vetëm maja e ajtsbergut, sepse fatura për bizneset



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

llogaritet të kushtojë nga 80-100 milionë euro. Projekti korruptiv për monitorimin e biznesit nuk duhet të zbatohet! Ky projekt cenon konkurrencën e lirë, mbyll vendet e punës dhe çon drejt falimentimit mijëra biznese".

REAGIMI

Pas akuzave të PD-së se ka një vendim të Këshillit të Ministrave për zëvendësimin e kasave fiskale për bizneset me pajisje të reja, reagoi ministri i Financave Arben Ahmetaj. Përmes një postimi në 'Facebook' Ah-

metaj mohoi kategorikisht këtë fakt, duke shtuar se ai vendim lidhet me forcimin e sistemit të kontrollit të sasive të hidrokarbureve, në favor të qytetarëve dhe buxhetit. Mes ironisë Ahmetaj sulmoi PD-në për deklaratat e përsëritura të 'Ekspertit X'. "Nuk ka asnjë VKM për ndryshimin e kasave fiskale për bizneset! Porçojmë sistemet e kontrollit të sasive të hidrokarbureve, në favor të qytetarëve dhe buxhetit! Shumë tipike e PD, deklarata e përsëritur për të disatën herë e "ekspertit X", që në rastin më të mirë është shfaqje paditurie të thellë, e në rastin më të keq, që është dhe më i mundur, dezinformim me dashje i qytetarëve", tha ai. Sipas Ahmetaj është humbje kohe t'u kthesh përgjigje për çdo budallallëk! "Për qytetarët që meritojnë të sqarohen, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 31.10.2018, nuk ka të

bëjë aspak me kasat fiskale të bizneseve, por lidhet vetëm me sistemet fiskale për kontrollin e sasive në shoqëritë e hidrokarbureve dhe të shitjes së tyre me pakicë. Së pari, ka një ndryshim thelbësor mes "sistemeve fiskale" dhe "kasave fiskale" dhe së dyti, efekti i kësaj VKM-je shtrihet vetëm mbi rreth 3 mijë sisteme fiskale të lidhura me sektorin hidrokarbur dhe aspak mbi rreth 145 mijë kasa apo pajisje fiskale që përdoren nga bizneset e tjerë në Republikën e Shqipërisë. Vetëm "ekspertit X" i PD nuk e lexon dot atë që është e shkruar e zeza mbi të bardhë, ose për meritën e tij, nuk arin ta kuptojë. Ky standard i ri që aplikohet për shoqëritë e hidrokarbureve, është një hap më tej për forcimin e kontrollit dhe të monitorimit të këtyj sektori të rëndësishëm duke mbyllur hapësirat potenciale për evazion", deklaroi z.Ahmetaj.

Shoqëria permbartimore JUSTITIA

Shoqëria permbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë , për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipoteke NBG BANK, me këto të dhëna:

- **Lloji i pasurisë** Are+ Truall me sip. 3000 m2, nr.pasurie 58/9 vol 8 fq78, zk.1475 , Derven, KRUIJE
- **Cmimi** me të cilin fillon shitja në ankand është 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) EUR. Ankand zvizohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartësist gjyqësor, me
- **Adrese:** Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria permbartimore JUSTITIA

Shoqëria permbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë , për shitjen e pasurisë së paluajtshme, për të cilën ka vene hipoteke NBG BANK, me këto të dhëna:

- **Lloji i pasurisë** me sip. 189 m2 nr.pasurie 51189nd/1, zk.4350 vol 28 fq146 RR.PMYZQAFI TIRANË në pronësi të z.Ajlan Rahmi BAHOLLU
- **Cmimi** me të cilin fillon shitja në ankand është 256.800 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) EUR
- **Lloji i apartamentit** sip.132m2 zk.8390 nr.pas.51189nd/1-119 vol.28 fq146 Rruga Prkop Myzeqari TIRANË në pronësi të z.Ajlan Rahmi BAHOLLU.
- **Cmimi** me të cilin fillon shitja në ankand është 105.600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) EUR
- **Ankand zvizohet** në datën 03.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartësist gjyqësor, me adrese Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARTIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria e paluajtshme kolaterale të llojit "Pyll + Kullosë", me sipërfaqe totale 190.000 m2, zona kadastrale 3028, me adresë POROVLORË, në pronësi të hipotekuesit z. FATION UKA.

ÇMIMI 1.149.120 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

VLORË - Policia e Vlorës në bashkëpunim me strukturën tjetër të Policisë së Shtetit kanë goditur një grup që merrej me shit-bletje të lëndëve narkotike duke arrestuar 5 persona dhe sekuestruar rreth 50 kg kanabis sativa "çokollatë" me vlerë rreth 100 mijë euro. Bëhet fjalë për shtetasit: Sokol Bushi, 23 vjeç, banues në fshatin Llakatund; Arben Metaj, 47 vjeç, banues në Vlorë; Martin Bushi, banues në fshatin Llakatund; Edi Tafa, 22 vjeç, banues në Kamëz, Tiranë dhe Renaldo Gecaj, 46 vjeç, banues në Paskuqan, Tiranë. Mësohet se operacioni policor antitrogë, fillimisht ka nisur në Vlorë nga Seksioni për Hetimin e Narko-

Goditja e grupit kriminal, policia i ndoqi nga Vlorë në Tiranë

Sekuestrohen 50 kg kanabis, çokollatë me vlerë 100 mijë euro, përfundojnë në pranga 5 persona

PERSONAT E ARRESTUAR

1. Sokol Bushi, 23 vjeç, banues në fshatin Llakatund, Vlorë.
2. Arben Metaj, 47 vjeç, banues në Vlorë.
3. Martin Bushi, banues në fshatin Llakatund, Vlorë.
4. Edi Tafa, 22 vjeç, banues në Kamëz, Tiranë.
5. Renaldo Gecaj, 46 vjeç, banues në Paskuqan, Tiranë.

tilkëve, ku nga hetimet e kryera, shtetasit Arben Metaj dhe Martin e Sokol Bushi, dyshojë se pasi kishin siguru-

ar një sasi lënde narkotike të presuar në formë çokollate në Vlorë, do ta transportonin atë me ndihmën e një autom-

jeti tip kamioninë drejt Tiranës. Falë punës së mirëorganizuar, ka filluar ndjekja nga ana e Seksionit të Hetimit të Narkotikëve në bashkëpunim të ngushtë me forcat e tjera të Policisë së Shtetit, nga Vlorë në drejtim të Tiranës me qëllim kapjen dhe të personave që do blinin lëndën narkotike. Policia ka mbajtur nën vëzhgim personat që transportonin lëndën narkotike dhe në momentin kur shtetasit Renaldo Gecaj dhe Edi Tafa, në Tiranë do



Operacioni i policisë në Vlorë dhe Tiranë

blinin lëndën narkotike, policia ka ndërhyrë duke arrestuar të gjithë shtetasit e përfshirë në këtë rast të shitblerjes së lëndëve narkotike. Në kuadër të veprimeve procedurale, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale: rreth 50 kg hashash e llojit "çokollatë"; 1 automjet

frigoriferik tip "Renault"; 1 autoveturë tip "Peugeot 407" dhe 7 aparate celulare. Materialet do t'i referohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në ngarkim të këtyre shtetasve për veprën penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve" kryer në bashkëpunim.

Sekuestrohen 2100 goma, prangosen dhe 4 persona të tjerë

Kontrabandë me gomat e përdorura, arrestohen 5 doganierë të Qafë-Thanës

Policia e SHÇBA: Akuzohen për shpërdorim detyre

KORÇË

Nëntë persona, ku pesë prej të cilëve punonjës së doganës së Qafë-Thanës janë arrestuar për kontrabandë të gomave të përdorura. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec finalizuan me sukses një operacion të ndjekur me metoda speciale të hetimit. Mësohet se punonjësit e doganës në fjalë akuzohen për veprën penale "Shpërdorim detyre", pasi favorizojnë kontrabandë gomash makinash. Përveç punonjësve, në pranga kanë përfunduar edhe 4 persona të tjerë. Burime zyrtare nga drejtoria e Policisë së qarkut të Korçës bënë me dije se në sajë të një pune të mirëorganizuar nga strukturat e lartpërmendura, u bë i mundur arrestimi në flagrancë i shtetasve: Stefan Hila, 50 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë përgjegjës turni në Doganën e Qafë-Thanës; Anesti Tushinka, 40 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë doganier parkingu pranë Doganës në Qafë-Thanë; Ilir Spahiu, 44 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë doganier pranë Doganës në Qafë-Thanë; Lefter Duraj, 64 vjeç, banues në Tiranë, me detyrë përgjegjës turni i grupit të antikntrabandës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Mikel Goxharaj, 41 vjeç, banues në Tiranë, me detyrë inspektor i grupit të antikntrabandës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, (të pestë për veprën penale "Shpërdorim detyre"). Po të njëjtat burime thanë se janë

prangosur dhe shtetasit: Kelti Ristani, 42 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë agjent doganor i një kompanie me seli në degën doganore Qafë-Thanë; Edmond Kodra, 61 vjeç, banues në fshatin Sovjan, Korçë, poseduesi i gomave; Stojmir Treneski, 42 vjeç, banues në Ohër, Maqedoni, shoferi i kamionit si dhe Petraq Dimko, 54 vjeç, banues në fshatin Sovjan, Korçë, poseduesi i ambientit ku magazinohet malli kontrabandë. Sipas hetuesve të çështjes, arrestimi i shtetasve të mësipërm, u krye pasi, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, dyshohet se kanë bërë të mundur futjen kontrabandë të një kamioni me rreth 2100 goma të përdorura, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Qafë-Thanë, të ngarkuara në mjetin tip kamion me drejtues shtetasin Stojmir Treneski, i cili u ndalua mbrëmjen e djeshme, nga shërbimet e policisë në aksin rrugor Pogradec-Maliq, pranë fshatit Sovjan, teksa po tentonte të shkakonte mallin e kontrabanduar, në magazinën e Petraq Dimkos. Në vijim të veprimeve procedurale, u bë sekuestrimi i kamionit që transportonte mallin kontrabandë së bashku me mallin (rreth 2100 goma të përdorura). Ndërsa, vijojnë hetimet për të dokumentuar veprimtarinë e personave të tjerë që mund të jenë implikuar në këtë linjë kontrabandimi.



Kamionit i sekuestruar nga policia

PERSONAT E ARRESTUAR PËR KONTRABANDË

1. Stefan Hila, 50 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë përgjegjës turni në Doganën e Qafë-Thanës.
2. Anesti Tushinka, 40 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë doganier parkingu pranë Doganës në Qafë-Thanë.
3. Ilir Spahiu, 44 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë doganier pranë Doganës në Qafë-Thanë.
4. Lefter Duraj, 64 vjeç, banues në Tiranë, me detyrë përgjegjës turni i grupit të antikntrabandës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
5. Mikel Goxharaj, 41 vjeç, banues në Tiranë, me detyrë inspektor i grupit të antikntrabandës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
6. Kelti Ristani, 42 vjeç, banues në Pogradec, me detyrë agjent doganor i një kompanie me seli në degën doganore Qafë-Thanë.
7. Edmond Kodra, 61 vjeç, banues në fshatin Sovjan, Korçë, poseduesi i gomave.
8. Stojmir Treneski, 42 vjeç, banues në Ohër, Maqedoni, shoferi i kamionit.
9. Petraq Dimko, 54 vjeç, banues në fshatin Sovjan, Korçë, poseduesi i ambientit ku magazinohet malli kontrabandë.



Drogë nga Shqipëria me aromë jasemini, 6 persona të arrestuar në Brindisi

ITALI - Mëngjesin e djeshëm karabinierët kanë arrestuar 6 persona ndaj të cilëve ishte lëshuar urdhër-arresti nga gjykata e Brindisit me kërkesë të prokurorisë lokale të Republikës. Ata akuzohen për posedim dhe shpërndarje droge në rrethana të rënduara pasi kanë tregtuar sasi të mëdha. Me shumë se 250 kg marijuanë dhe gjysmë kile kokainë të sekuestruara gjatë hetimit në verën e këtij viti. Ata ishin të parët në fushën kombëtare për të hartuar sistemin origjinal dhe efektiv të transportimit të sasive të mëdha të narkotikëve nga bregdeti shqiptar në Salento, duke e futur atë në tubat e një gomoneje, së bashku me disa shpërndarës të esencave aromatike me jasemin për të shmangur nuhatjen nga qentë e drogës. Janë duke u zhvilluar kërkime të shumta nga më shumë se 80 karabinierë, duke përfshirë ato të skuadrës së sapofornuar "Gjuetarët" të Gargano, një njësi qeni dhe një helikopter. Gomonia me drogë u kap me 4 korrik 2018 ndërsa transportohej në autostradë nga një automjet. Në pranga u vunë 2 italianë nga Brindisi Fulvio Lonero e Massimo Ferrero. Detajet e operacionit do të publikohen në orët në vijim nga policia italiane.

Operacioni, ja si tentoi t'i ikte policisë 38-vjeçari Naim Xharri



ELBASAN

Policia dhe FNSH "blindojnë" Elbasanin, arrestohen dy të "fortët" e fisit Çapja

Kontrollet në lagjen "Emin Matraxhiu", sekuestrohen armë e fishekë si dhe një minë me telekomandë

Policia në bashkëpunim me Forcat e Ndërryres së Shejtit të Tiranës dhe kanë ndërmarrë një operacion në qytetin e Elbasanit, ndërsa janë arrestuar dy persona si dhe janë shoqëruar për verifikim dhe tetë të tjerë. Mësohet se gjatë operacionit që drejtohej nga kreu i policisë së Elbasanit, Altin Qato është vënë në pranga 57-vjeçari Enver Çapja si dhe 38-vjeçari Naim Gjarri. Sipas bluve, gjatë kontrolleve të ushtruara në lagjen "Emin Matraxhiu" janë gjetur dhe sekuestruar dy armë zjarri, municion luftarak, minë me telekomandë si dhe një sasi parash. Po të njëjtat burime thanë se operacioni është përqendruar në zona të ndryshme të qytetit të Elbasanit, dhe për disa orë të tjera furgoni i policisë është parë të stacionohet pranë hotel "Univers", në pronësi të fisit Çapja, të cilët kanë edhe banesat e tyre aty pranë. Operacioni në fjalë u ndërmor një ditë pas atentatit me granatë ndaj 32-vjeçarit Albert Alterziu, në lagjen "Partizani" të këtij qyteti. Ndërkaq, policia dhe FNSH pritet të arrestojë një tjetër grup kriminal, ndërkohë që po mbahen të rrethuara disa banesa të tjera.

OPERACIONI

"Nga ana e strukturave të DVP Elbasan në bashkëpunim me FNSH Tiranë, në kuadër të planit të masave të hartuar nga DVP Elbasan, për rritjen e sigurisë publike, parandalimin e ngjarjeve të mundshme kriminale, kapjen e personave që lëvizin me armë pa leje, kontrollin e automjeteve, ambienteve që përdorin personat me precedentë kriminalë dhe penale, si rezultat i një pune të mirëorganizuar policore, në lagjen "Emin Matraxhiu", në ambientet e një bar kafe në pronësi të shtetasit Enver Çapja janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale: 22 fishekë model 54, kalibër 7.62mm; një palë targa



Një nga të arrestuarit, gjatë operacionit në Elbasan



Mina dhe armët e sekuestruara nga policia



Policia gjatë kontrolleve në Elbasan

automjeti gjermane; një sasi prej 2110 euro dhe 372.000 lekë", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Po sipas njoftimit të bluve, gjatë momentit kur policia po kryente kontroll në lokal, shtetasit Naim Gjarri është larguar me shpejtësi në drejtim të banesës. Policia është vënë në ndjekje të tij dhe gjatë kontrol-

TAKIMI I MINISTRIT LLESHAJ

Vetëm tri ditë më parë, Sandër Lleshaj, ministri i Brendshëm (u deketrua nga presidenti Ilir Meta) zhvilloi një takim me drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Lleshaj u informua mbi situatën e rendit dhe sigurisë publike, ndërsa kërkoi performancë nga ana e trupës policore dhe goditje të shpejtë të grupeve kriminale. Kjo dhe për faktin se Elbasani është përmendur si qyteti i "listës së zezë" për shkak të kriminalitetit.

ATENTATI ME GRANATË

Një shpërthim me granatë në një lokal ka tronditur banorët e Elbasanit në orët e para të mëngjesit të së enjtes. Ngjarja e rëndë, ku mbeti i plagosur 32-vjeçari Albert Alterziu ndodhi në lagjen "Partizani" të këtij qyteti, në vendin e quajtur "Gurabardhi". Mësohet se i riu ndodhej në një dhomë ngjitur me lokal në pronësi të tij, kur ndodhi shpërthimi. Ai është dërguar urgjentisht në spitalin kirurgjikal të Elbasanit ku i është dhënë ndihma e parë mjekësore. Bluzat e bardha të këtij qyteti bënë me dije se Alterziu ka marrë plagë të rënda, por ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Pas hetimeve paraprake, blutë deklaruan se dyshohet që ngjarja ka marrë shkas për motive hakmarrjeje.

lit të banesës janë gjetur edhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale: një armë zjarri pistoletë e markës CLOCK, kalibër 9mm, me një krehër të vendosur në të me 13 fishekë; një armë zjarri e tipit pistoletë e markës TT, me krehër të vendosur në të me 7 fishekë; 3 pako me fishekë model 54, kalibër

7.62mm, me nga 70 fishekë secila nga pakot; një krehër pistolette si ato të pistoletave CLOCK, me 15 fishekë model 9 mm të vendosur në të dhe një pako e dyshuar si lëndë eksplozive, minë me sahat. Në përfundim të veprimeve, bazuar në prova dhe fakte ligjore, si dhe pas konsultës me prokurorinë e rrethit u

arrestuan në flagrancë shtetasit: Enver Çapja, 57 vjeç, banues në Elbasan dhe Naim Gjarri, 38 vjeç, banues në Elbasan. Materialet hetimore do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për veprën penale të "Mbajtje pa leje dhe prdhim i armëve dhe municioneve luftarake".

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQUAR ME FTESA DIREKTE

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 45,610,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshesme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferata duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 20 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Furgoni bie 40m në humnerë, 3 të plagosur në Librazhd

Përplasen dy mjete në aksin Laç-Milot, vdes burri, në gjendje të rëndë bashkëshortja

LEZHË/LIBRAZHËD - Një i vdekur dhe katër persona të tjerë të plagosur është bilanci i dy aksidentëve automobilistike të ndodhura dje në Lezhë dhe në Librazhd. Sipas burimeve policore, aksidenti i parë me 3 të plagosur u shënuam mëngjesin e djeshëm në aksin rrugor Librazhd-Qafë Thanë, në Pishkash. Mësohet se një furgon mall-rohet me targa AA 369 UF e me drejtues 32-vjeçarin Markel Merkolli, banues në fshatin Vloçisht, Korçë, ka dalë nga rruga dhe ka rënë rreth 40 metra në humnerë. Si pasojë janë aksidentuar drejtuesi i mjetit dhe dy pasagjerët, Endri Merkolli, 22 vjeç dhe Kristo Çika, 31 vjeç, banues në fshatin Vloçisht Korçë, të cilët u dërguan në spitalin e Librazhdit, në gjendje të rëndë. Ndërsa, blutë kanë nisur hetimet për zbardhjen e shkakut. Ndërsa, aksidenti i dytë ndodhi paraditen e djeshme në aksin e vjetër rrugor Laç-Milot, në afërsi të fshatit Malbardhë. Një mjet kamion me drejtues shtetasin A.L.L. 40 vjeç, banues në Laç, ka aksidentuar mjetin ciklomotor me drejtues shtetasin Z.H. 52 vjeç, banues në Milot. Për pasojë, ka humbur jetën drejtuesi i ciklomotorit, si dhe është lënduar bashkëshortja e tij shtetasja Sh.H. pasagjere në ciklomotor. Ajo është dërguar në Spitalin e Traumës në Tiranë për ndihmën e nevojshme mjekësore. Drejtuesi i kamionit është shoqëruar në ambientet e policisë për veprime të mëtejshme procedurale hetimore.

Lista e tetë/ Ministria e Financave publikon emrat e personave që marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit

5.700 të përndjekurit që marrin kompensimin

Tabela me çdo dokument që mungon në secilën dosje të trashëgimtarëve

Rreth 5.700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpër-



blimin. Të gjithë personat kanë afati deri më 9 shkurt 2019 për të plotësuar dosjen.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të pa-nevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/ Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në kra-

hasim me dëshminë e trashëgimit apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq.

EMRAT ME PERFITUESIT E KOMPENSIMIT TE TE PERNDJEKURVE

NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	EMER	ATESA	MBIEMER	KOPJE TE LETRA SHPIRIT	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE VETJE	CERTIFIKATE FAMILIAR	DESHMI TRASHIGIM	PRO-KURIE	CERTIFIKATE GJENJERA LIREZUES
			Ilona	bob	kola	v						
			ine	bob	reori	v						
			ilca	bob	metko	v						
7145	Konstantin	Konstili	Vlasi	Qizilako	Konstili	v	x	v	v	v		
8747	Thodorci	Konstantin	Marije	Adhemi	Konstantin	v		v	v	v		
			Elizabete	Thodorci	Pali	v		v	v	v		
			Spiro	Thodorci	Konstantin	v		v	v	v		
9208	Lidije	Biba	Majega	Sotir	Biba	v	x	v	v	v		
899	Muharezen	Nxhata	Hava	Muharezen	Nxhata	v	x	v	v	v		
7445	Koco	Gjini	Martin	Sotir	Gradnata	v	v	v	x	v		
292	Daut	Bytyku	Shaqpe	Mucenja	Bytyku	v	x	v	v	v		
799	Pandeli	ZOGRAFI	LIBI	ZOGRAFI	ZOGRAFI	v		v	v	v		
9911	MASAR	VEZIVJOLLI	HAMBERE	HAMBERE	VEZIVJOLLI	v		v	v	v		
			VEROLJA	MAGHAR	BIET	v	x	v	v	v		
			SHIZANA	MAGHAR	SHINDOLLI	v	x	v	v	v		
			TEUTA	MAGHAR	VEZIVJOLLI	v	x	v	v	v		
3753	SALIM	KOKALARI	HATINBE	SALIM	KOKALARI	v		x	v	v		
			FRANZIJA	SALIM	KOKALARI	v		v	v	v		
			PLATON	SALIM	KOKALARI	v		v	v	v		
136	SUL	HARRI	DURIM	SUL	HARRI	v	x	v	v	v		
			FLAMBER	SUL	HARRI	v	x	v	v	v		
			NERGJIM	SUL	HARRI	v	x	v	v	v		
				SUL	HARRI	v	x	v	v	v		
			SAGAN	SUL	HARRI	v		v	v	v		
			SOPOT	SUL	HARRI	v		v	v	v		
2038	Dilaver	HEKTRKAN	ENVER	DILAVER	VELHAJ	v	x	v	v	v		
2546	ISMAH	KAFENSHU	SHEME	SHABAN	KAFENSHU	v		v	v	v		
			FESTIM	ISMAH	KAFENSHU	x		v	v	v		
			ELI	ISMAH	KAFENSHU	x		v	v	v		
			NADIRE	ISMAH	KAFENSHU	x		v	v	v		
			OSMAN	ISMAH	KAFENSHU	x		v	v	v		
			QIRBEM	ISMAH	KAFENSHU	x		v	v	v		
			SHEMAH	ISMAH	KAFENSHU	x		v	v	v		
3232	RAKIP	VESHAI	HASSE	ISTREP	VESHAI	v		v	v	v		
			BAJRAM	RAKIP	VESHAI	v	x	v	v	v		
			FAIK	RAKIP	VESHAI	v		v	v	v		
			SHAHI	RAKIP	VESHAI	v		v	v	v		
			ELI	RAKIP	ISARAJ	v	x	v	v	v		
4550	FERTI	TONUZI	HAMBERDE	HASAN	TONUZI	v		v	x	v		
			VEROLJA	FERTI	SPAHU	v	x	v	x	v		
			TONUZ	FERTI	TONUZI	x	x	x	x	v		
4530	KOL	SMALAJ	NHEVAJRE	FERTI	TONUZI	v		v	v	v		
			LELE	SMALAJ	SMALAJ	v		v	v	v		
			GERGJ	KOL	SMALAJ	v	x	v	v	v		
			DRANDE	KOL	SMALAJ	x	x	v	v	v		
			PSHIBI	KOL	SMALAJ	x	x	v	v	v		
			AMR	KOL	TINAJ	x	x	v	v	v		
1365	KAMER	KAZAZI	SANDE	KAZAZI	KAZAZI	v	v	v	v	v		
			TOMORRE	KAMER	VRAPI	v	x	v	v	v		
2819	ISLAM	YSKOLLARI	SINDORRELA	KAMER	VRAPI	v	x	v	v	v		
			SYRBA	ISMAH	YSKOLLARI	v	x	v	v	v		
2506	FOTO	DULO	ALFERSANDEH	FOTO	DULO	v		v	v	v		
			ABDULLI	FOTO	DULO	v	x	v	v	v		
			FREDERIK	FOTO	LAMANI	v		v	v	v		
			MAKRETA	FOTO	DULO	x		v	v	v		
			PIRO	FOTO	DULO	x		v	v	v		
846	Ibrahim	Shos	Adi	Ibrahim	Shos	v		v	v	v		
						v		v	v	v		
			Idlan	Ibrahim	Shos	v		v	x	v		

Opinion i Ditës

Panairi i ri i librit, ose "Panairi i përkthimeve"

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

... Çehovin, Dostojevskin, Hygonë, Stendalin, Dikensin, Andriçin, Ricosin, Lorkën, Markesin, Murakamin etj., etj...

Përshtypjet e para të këtij panairi të ri janë të veçanta. Pasi kalon si në një paradë midis stendave me libra të përkthyer, mendon se nuk je në një panair shqiptar, as në Shqipëri. Mund të jesh në panairin e librit të Parisit, të Frankfurtit, të Gjenezës, të Bolonjës, vetëm në Panairin e librit të Tiranës nuk mund të jesh...Nuk do gabohesha po të thosha se 90% e librave të këtij panairi janë përkthime nga gjuhët e huaja.

Ka disa vite që këtë drejtim i kanë dhënë botuesit e shumtë, nisur dhe nga përfitimi i shpejtë. Është e vertetë. Libri është në krizë. Dhe shtëpitë botuese, janë në krizë, për shkak të shitjes së ngadalë të librit dhe për shkak të rënies graduale të lexuesit.

Këtë panair edhe pse do e quaja "Panairi i përkthimeve" nuk mund t'ia ul vlerat, përkthyesve as botuesve. Duke kaluar pranë stendave ndjen një krenari të veçantë për punën, guximin dhe iniciativën aventureske të botuesve, për të sjellë në gjuhën shqipe gjithë këtë thesar të madh e të paçmuar të letërsisë dhe filozofisë botërore.

Problemi që kam unë me librin qëndron tek raportit që duhet të kishte midis letërsisë së autorëve të huaj me letërsinë shqiptare. Çdo nacionalitet synon stimulimin dhe reklamimin e vlerave kombëtare. Këtë gjë e kam parë vet në panairin e librit të Gjenezës, të Bolonjës, dhe të Frankfurtit, ku botuesit e do shteti i japin përparësi autorëve të tyre, ndërsa në panairin tonë autorët shqiptarë ndihen të huaj e të papërfillur. Një detyrë e tillë i takon Ministrisë së Kulturës e cila, edhe për shkak se Ministria dhe drejtoresha e librit janë përkthyes, është kthyer në një institucion të shoqërisë "traduki", ndërkohë që duhet të ndodhte e kundërta.

Në tre lexuesit e mundshëm të librit shqiptar, që do të klasifikoj, i pari, "i munguari", është ai që ka emigruar, "i lodhuri" është ai që frekuenton çdo vit panairin dhe investigon librat e mirë, ndërsa lexuesi i tretë, "i distancuari" është një lexues me Iphon në xhep. Lufta me librin duhet të quhet lufta për afrimin e tri llojeve të lexuesve shqiptarë. Lidhur me këtë panair të ri, them me bindje, se, botuesit e kanë gjetur shpëtimin tek letërsia e përkthyer, e cila në të shumtën e rasteve botohet pa kontratë për të drejtat e autorit, shtu këtu dhe faktin që përkthimet nuk bëhen nga përkthyes profesionistë. Provo të hapësh faqet e para të disa librave të përkthyer dhe do të ndeshesh me emra krejtësisht të panjohur.

Ka një vërshim të madh përk-



thyesish diletantë, të cilët paguhen dobët nga shtëpitë botuese, ndërkohë që shumë përkthyes të mirë i gjen brenda dhe jashtë vendit. Bumi i emigracionit ka bërë që në fushën e përkthimeve të gesh përkthyes ekselent, por ata duhen kërkuar, duhen gjetur dhe duhen paguar sipas standardeve bashkëkohore të përkthimit, të cilat janë të sanksionuara me ligj...Duke vizituar këtë panair mendoj se raporti letërsi shqiptare- letërsi e huaj është tejet në favor të letërsisë së huaj. Dhe kur sheh librin e një autori shqiptar, dijeni mirë se pagesa e librit është bërë prej vet autorit. Shtëpia botuese i ka dhënë mundësinë e ISBN-së. Unë nuk jam kundër përkthimeve, madje në këtë panair gjen vepra të autorëve shumë të njohur, mirëpo, të mbushësh një panair me përkthime do të thotë të synosh "kolonizimin kulturor të një kombi me traditë të mëdha kulturore" Pas 45 vjet izolacioni kulturor ne kemi pasur një uri të madhe për librin e huaj, por tashmë, konstatojmë

qetësisht se kjo uri jo vetëm ka kaluar, por është kthyer në të keqen e vet. Lexuesit shqiptarë është velur me letërsinë e huaj, ai nuk gjen problemet e vendit të vet, nuk gjen karaktere dhe përshkrime të vendit të vet. Nga ana tjetër, kjo letërsi, e përkthyer, i ka çmimet të krijuara. Dominon shifra 7 euro dhe 9 euro për të mos thënë që për disa nga librat që kërkohen nga lexuesi çmimet e tyre variojnë nga 1000-1800 lekë të reja. Librin për fëmijë "Hari Potter" të cilin do ta blija për nipin tim, kushton 1400 lekë të reja. Çështje e vërteta, midis morisë së përkthimeve të një letërsie limonatë gjen dhe libra të rëndësishëm. Gjen romane nobelistësh, romane klasikë, libra filozofikë, letërsi për fëmijë, etj., të cilat unë do të kisha dëshirë t'i kisha në bibliotekën time, por, xhepi i një pensionisti, i një studenti, i një nxënësi, apo i një punonjësi, nuk mund t'u përgjigjet çmimeve të botuesve. Unë i di mirë kostot e librave. Po të mendosh për një tirazh mesatar 500 kopje, gjë e pran-

ueshme edhe për një shtëpi botuese pariziane, them me bindje se disa nga botuesit e këtij panairi e kërkojnë fitimin mbi 50%.

"Panairi i librit" ka një histori të vet disaveqare, por kohët e fundit ka ardhur duke u konsoliduar dhe përqendruar si një "panair i përkthimeve"

Serish vërejtjet bien mbi Ministrinë e Kulturës, e cila duhet t'u vijë në ndihmë autorëve me anë të subvencioneve. Një vend nuk mbahet dot me mall të huaj. Krizimtaria letrare është një prodhimtari intelektual që kërkon ndihmën e shtetit.

Megjithatë, kur viziton këtë panair ndjen kënaqësi të veçantë, pasi vëren që është bërë një investim kolossal dhe me vështirësi të shumta, për të arritur në një kohë të shkurtër këtë mal me libra autorësh, vendas dhe të huaj. Një kënaqësi tjetër e këtij panairi është kur sheh sesi, disa shtëpi botuese kanë krijuar profilizime. "Toena" me librin tradicional, "Dituria" me shumanësinë e llojeve, "Onufri" me botimin e plotë të Kadaresës, "Uegeni" dhe "Eriku" me botimet e disa autorëve shqiptarë, "Skënderbeg book" me botimin e disa nobelistëve, "Omska" me koptarinat cilësore dhe botimin e autorëve të rëndësishëm botërorë. "Uegeni" me letërsinë ruse: Çehovin, Dostojevsk Stendal, etj., "Noli" me Nicen, etj. Do të ishte mirë që shembulli i Sh.b. "Onufri" me botimin e plotë të Kadaresës të ndiqej nga botuesit. "Toena" këtë gjë e ka bërë me F.Kongolin, Z.Çelën, N. Lerën dhe D.Çulin... "Konika" e ka bërë me "Konika", "Erik" e ka bërë me Zeqon. Një shtëpi tjetër e ka bërë me krijimtarinë e Petro Markos. Mendoj se ka hapësirë dhe për më shumë

autorë të tjerë të cilët këta botues duhet t'i bëjnë të njohur. Personalisht do të doja reklamimin e disa autorëve që unë i vlerësoj shumë, si,

F.Halitin, M.Vyshkën, F.Reshpen, H.Mecen, K.Petritin, M.Vyshkën, K.Blushin, R.Gjozën, etj. Në këtë panair marrin pjesë dhe disa shtëpi botuese kosovare dhe shqiptaro-maqedonase. Kjo gjë ia shton vlerat panairit, duke i dhënë një dimension mbarëkombëtar, mirëpo, janë të rralla ato raste që një shkrimtar kosovar ose maqedonas të botohet i plotë nga një shtëpi botuese shqiptare, ndërkohë që botuesit e trevave shqiptare, të Kosovës dhe të Maqedonisë, në këtë panair, kanë sjellë botimet e disa autorëve shqiptarë. Te ky panair të bie në sy, se si, një autor shqiptar si R.Gjoza e gjen të stenda e shtëpisë botuese "Buzuku" me disa botime, ndërkohë që te asnjë shtëpi botuese shqiptare nuk gjen veprat e një autori kosovar. Jemi të gjithë dëshmitarë se si priten autorët vendas nga shtëpitë botuese. Janë raste të rralla ato kur një botues merr përsipër botimin e një veprë letrare, me shpenzimet e veta.

Me sa jam në dijeni, Ministria e Kulturës ka aftruar një lloj klani të ashtuquajtur shkrimtarë. Është ai klan që dhe përfiton nga kjo ministri dhe kur gjykon për përkthimin e librave.

Sa i përket shtëpitë botuese, unë mendoj se ato kanë vështirësi të veta. Së pari, pasi iu është larguar lexuesi tradicional. Së dyti, libri, ndryshe nga çdo produkt që del në treg, ka një shittje të ngadalë. Libri nuk ia merr dot fitimin brenda një viti.

Së treti, libri ka funksion edukativ. Për këtë arsye mendoj që drejtorisë së Librit në Ministrinë e Kulturës i del si detyrë ta ndjekë në vazhdimësi krijimtarinë e autorëve shqiptarë, edhe përmes studimeve, por, edhe të subvencionojë disa nga autorët shqiptarë, përmes shtëpitë botuese. Një punë lavdëruese ka bërë shtëpia botuese "Toena" dhe jo vetëm, e cila ka botuar shumë shkrimtarë shqiptarë me fondet e veta, madje ka botuar dy kolana cilësore, atë të poezisë dhe të tregimit. Në shembullin e kësaj shtëpitë botuese duhet të ecnin dhe të tjera shtëpi botuese, në qoftë se e kuptojnë drejt misionin e vet. Është fjala për shkrimtarë të talentuar, të cilët i kemi të pakët si uranumit dhe duhet t'i konsiderojmë vlerë kombëtare. Ndryshe, çfarë kuptimi do të kishte kultura e një vendi kur ajo nuk sponsorizon talentet e veçanta, në letërsi, muzikë, pikturë dhe në artet e tjera. Më vjen mirë që, kohët e fundit, në zërat e krijuara për biznesin dhe investimet, ka dhe një zë të rëndësishëm, i cili quhet "investimi për talentet". Së fundi, unë do t'iu lutesha përmes shtetit botuesve dhe drejtorisë së Librit që të mendojnë pak dhe për ligjin e sponsorizimit, i cili ende nuk kuptohet drejt se çfarë humb dhe çfarë fiton shteti dhe biznesmenët nga ky ligj.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I
RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvjka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

BalkanWeb.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIMIK.**



**MERRNI NË KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NË APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET**



**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET
KERKONI NË APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID**

BalkanWeb.com
BW

FALAS



REPUBLICA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

NJOFTIM – SHPALLJE

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOHSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dn pika 2, 96 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtesës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakohshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtesës me **Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018**, ka miratuar;

■ Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërimin gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakohshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës **Znj. Altina Xhoxhaj**, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

■ Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;

■ Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (*numër telefon/email*);

■ Fotokopje të kartës së identitetit;

■ Dokumentacionin shoqëruës nëpërmjet të cilit vërteton përbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

■ Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.

■ Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e lsh-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.

■ Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, me postë të gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

■ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një

veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës. 5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

■ Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte: a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit nga data e kandidimit;

d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;

e) të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) vjetërsisë në profesion;

b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;

c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;

d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

e) të mos jetë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerhme me të; dhe arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore. Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Biv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dojet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
Numri telefonit: 042389898

E DIEL

18 Nëntor

2018



Zbulohet gazeta e parë e Shqipërisë

NGA ILIRIAN AGOLLI

Shkrimi sjell fakte të reja mbi botimet e para publicistike në Shqipëri. Palë historianëve turq, publiku ynë mëson se gazeta "Iskodra" ka dalë në dritë 11 vjet më parë nga ç'e dinë deri sot bibliografët e shtypit shqiptar. Pra, "Isko-

dra" doli për herë të parë më 1868 dhe ridoli më 1879. Nga kjo shtyrje date me plot 11 vjet në thellësi të kohës, gazeta "Iskodra" bëhet e para gazetë e botuar në territoret shqiptare, duke lënë pas gazetën "Prizren", e cila doli në dritë në gusht 1871.

NGA BEN ANDONI

Lajmi më i frikshëm që ka mbizotëruar në javët e fundit gjeneroi nga referenca e INSTAT-it, sipas të cilës 1 milionë shqiptarë nuk kishin prekur madje edhe një libër të vetëm. I frikshëm ishte fakti që lajmi jo thjesht nuk u shqyrta si duhet në të gjithë hapësirën e tij, porse u bë pjesë e debatit. Kuptohet që palët politike ju përveshën njëra-tjetrës, kurse në masë nuk bëri ndonjë përshtypje. Tek e fundit, gjetja nuk ishte se qëndronte aq është shumë realitetit. Këtë e ndjen në përballjen e shumë njerëzve me argumentet, por këtë e gjen vazhdimisht edhe në diskursin publik që ngrihet, ku mungesa e diturisë është fare e dukshme.

Argumenti ynë shkon më tej, nëse me shqetësimet që ngritën botuesit në ditët e Panairit, do të kenë apo jo zgjidhje problemet e librit. Për fat është hequr TVSH sa i përket shpërndarjes së librit në Kosovë, ndërsa qeveria shqiptare mëton të kalojë Ligjin e ri për librin, ku do të ketë lehtësim të TVSH-së në disa nga hallkat e procesit, që përkthehet në një lehtësi të madhe për komunitetin që merret me librin. Problemi i vetëm qëndron në faktin sesa do të realizohet e gjithë kjo ndërmarrje dhe po ashtu nëse do të ngrihet apo jo Qendra e Librit. Për fat, shenjat janë të mira, ndërsa në shqetësimet e mëdha që po përballet në mandatin e dytë qeverisja e z. Edi Rama ka shumë gjasa që gjërat të ndryshojnë, qoftë edhe për të treguar një politikë ndryshe me librin.

Në fakt, shqetësimi më i madh mbetet qasja dhe paçka sloganeve që po hedhin njerëzit e librit nga Ministria e Kulturës, Shoqata e Botuesve dhe shumë aktorë të



PANAIRI 2018/

A do të lehtësohet libri?!

tjerë, një fakt duhet theksuar: Mungesa e leximit është një faktor i përbotsëm dhe për shkak se globalizmi i ka efektet e menjëhershme në të gjitha vendet, atëherë ky fenomen do të vinte edhe tek ne.

Mbi 60 aktivitete kanë qenë të pranishme mes autorëve, përkthyesve, botuesve me lexuesit, por pak është thënë për vetë problemet e njerëzve të librit. Për pa-

sat, për marrëdhëniet e botuesve me përkthyesit, për inkurajimin e autorëve të rinj, për përçarjen jo të vogël që ekziston mes botuesve dhe autorëve e shumë e shumë faktorëve të tjerë.

Në të gjitha aspektet duket sikur problemet i kanë vetëm botuesit, por në një farë mënyre edhe ata vetë, jo pak prej tyre, janë pjesë e problemit të sjellë.

Gjithsesi duhet uruar Panairi

dhe mjedisi shumë festiv, që sjell ashtu si duhet kritikuar gjithçka që lidhet me padrejtësinë, që edhe njerëzit e librit e kanë kultivuar jo pak mes vete.

Dhe, më keq akoma, shqetësimi më i madh është se ne përsërisim të njëjtat gjëra gjithmonë, pasi gjërat janë në një sistem tani dhe të shndërrosh sistemin duhet jo thjesht punë por vetëdije dhe mbi të gjitha shpirt të madh. Të pak-

tën njerëzit që bëjnë politikën e librit, e që kanë kaluar në përvojën e tyre me të gjitha partitë politike se kanë treguar këtë.

Në fund, kur panairi kalon, një gjë të mbetet në mendje: ishte një panair, si gjithë të tjerët, para tij. Vetëm nëse faktorët do arrijnë ta lehtësojnë librin, atëherë mund të themi, se ia vlejti e gjithë kjo punë e botuesve dhe e komunitetit të librit.

Në këtë numër: PROF. ALBERT DOJA, LUAN RAMA, ILIRIAN AGOLLI, DR. IRENA GJONI, NDUJE DEDAJ, A.MARKU ETJ

K

ZBULIMI

Shkrimi sjell fakte të reja mbi botimet e para publicistike në Shqipëri. Falë historianëve turq, publiku ynë mëson se gazeta "Iskodra" ka dalë në dritë 11 vjet më parë nga ç'ë dinë deri sot bibliografët e shtypit shqiptar. Pra, "Iskodra" doli për herë të parë më 1868 dhe ridoli më 1879. Nga kjo shtyrje date me plot 11 vjet në thellësi të kohës, gazeta "Iskodra" bëhet e para gazetë e botuar në territoret shqiptare, duke lënë pas gazetën "Prizreni", e cila doli në dritë në gusht 1871.

Zbulohet gazeta e parë e Shqipërisë

Botimi i panjohur doli në Shkodër 150 vjet më parë dhe ishte *Botimi i numrit të parë të gazetës "Iskodra" (1868)*

NGA ILIRJAN AGOLLI

Shkrimi sjell fakte të reja mbi botimet e para publicistike në Shqipëri. Falë historianëve turq, publiku ynë mëson se gazeta "Iskodra" ka dalë në dritë 11 vjet më parë nga ç'ë dinë deri sot bibliografët e shtypit shqiptar. Pra, "Iskodra" doli për herë të parë më 1868 dhe ridoli më 1879. Nga kjo shtyrje date me plot 11 vjet në thellësi të kohës, gazeta "Iskodra" bëhet e para gazetë e botuar në territoret shqiptare, duke lënë pas gazetën "Iskodra", e cila doli në dritë në gusht 1871.

Edhe pse vetëm në gjuhën osmane, "Iskodra" shënon gjurmën e parë të gazetarisë në Shqipëri, ndërsa Shkodra bëhet qyteti i parë, ku u vendos shtypshkronja e parë, që nxori publikime për qytetarët, një prodhim luksi për banorët e shkolluar: **GAZETA "ISKODRA" E PANJOHUR (1868)**

Historianët dhe bibliografët e shtypit shqiptar⁽¹⁾ deri pak kohë më parë nuk ishin në dijeni të faktit që gazeta "Iskodra" ishte botuar herën e parë qysh nga viti 1868. Në botimet e deritanishme të bëra në Tiranë përmendet⁽²⁾ se botimi i gazetës "Iskodra" u bë për herë të parë në vitin 1879. Por zbulimi i studiuesve turq, siç do ta shohim më poshtë, shënon një lajm me rëndësi tejte të veçantë edhe për historinë e shtypit e gazetarisë shqiptare. Kjo e bën gazetën "Iskodra" gazetën e parë të botuar në Shqipëri dhe vet Shkodrën qytetin e parë me gazetë dhe me shtypshkronjë.

Gazeta e parë⁽³⁾ që pa dritën e botimit në Perandorinë Osmane ishte **Takvim-i Vekayi** (Kalendari i Ngjarjeve). Numri i parë doli në vitin 1831 kur ende nuk kishte asnjë rregullorë për botimet, të cilat vlerësoheshin si veprime individuale. Në kuadër të Reformave të Tanzimatit u pa e nevojshme edhe hartimi i ligjeve e rregullave, që kishin të bënin me botimet. Për herë të parë Porta e Lartë vendosi "të rregullojë" ose, më mirë, të disiplinonë bazuar në ligj, botimet e cfarëdo lloji, përfshirë këtu edhe gazetën. Administrata osmane nisi⁽⁴⁾ nga mesi i shekullit XIX botimin e gazetave në gjithë qendrat e vilajeteve të perandorisë, përfshi edhe ato në krahinat shqiptare.

Rregullat e para dolën me miratimin e **Ligjit të Botimeve** dhe me **Ligjin e të Drejtave të Autorit** më 1857, i cili u pasua nga **Ligji Penal** më 1858, **Ligjet e Publikimeve** më 1864 dhe **Dekreti Sublim** i 1867. Mbi këtë trull ligjor dolën një numër i madh botimesh në kryeqytet dhe në qendrat e vilajeteve, të cilat mbuluan pothuaj hapësirën e krejt Perandorisë.

Porta e Lartë po në kuadër të Reformave të Tanzimatit riorganizoi vilajetet ekzistuese⁽⁵⁾ bazuar në "Rregulloret e Vilajeteve" të viteve 1864-1867. Kështu edhe vilajetet ekzistuese shqiptare pësuan ndryshime si parashikohet në këto Rregullore perandorake.

Vilajeti i Shkodrës iu nënshtrua në vitet 1867 / 68 Rregulloret të Vilajeteve dhe pësoi disa ndryshime të kufijve, pra të shtr-



irjes gjeografike, si edhe në nëndarjet administrative brenda vetë vilajetit (sanxhak, kaza e nahije). Po atë vit në Shkodër pa dritën e botimit, si në shumicën e vilajeteve të tjera të Perandorisë, për herë të parë gazeta "Iskodra".

Mes dyzinave me gazeta që u publikuan në kryeqendrat e vilajeteve në mbarë Perandorinë, studiuesi turk Atilla Girgin⁽⁶⁾ renditi ndër të parat e çelura ato që dolën në vilajetet shqiptare në vitin 1868, gazetën "Iskodra" (Shkodër, osmanisht), dhe gazetën **Yanya** (Janinë, osmanisht - greqisht). Sipas tij, gazetën e vilajeteve përmbanin lajme rreth sultanit, qeverisë dhe emërimit e zyrtarëve publikë, mbi institucionet publike të krahinës, mbi ndërtim rrugësh, hekurudhash, linjash telegrafike, mbi çështjet e shëndetit, arsimit, ekonomisë dhe policisë. Shkrimet e botuara në këto organe shtypi nuk mbanin emrat e autorëve apo gazetarëve. Një tjetër tipar i shumicës së këtyre gazetave është emri i gazetës i njëjtë me atë të vilajetit dhe gjuha e dytë e rajonit, krahas osmanishtes, që zinte një pjesë të gazetës.



Sipas⁽⁷⁾ studiuesit tjetër turk, Hifzi Topuz, ato ishin shumica buletine njoftimesh apo gazeta zyrtare të shtetit osman. Ai shton më shumë se Girgin në renditjen e tij të botimeve edhe gazetën **Selanik** (Selanik, osmanisht - greqisht, 1869), dhe gazetën **Aydin** (Izmir, osmanisht, 1874). Gazetat e vilajeteve shqiptare në Shkodër, Janinë, Prizren e Manastir a Selanik as në fillim e as më vonë nuk kishin fletë në gjuhën shqipe, siç ishin dygjuhëshe shumë nga gazetat e tjera e megjithatë ato shkruanin për jetën e shqiptarëve.

Gazeta **Yanya** (Janina) jep me detaje⁽⁸⁾ ceremonitë e diplomimit të nxënësve në gjimnazin "Zosimea", duke botuar me këtë rast edhe deklaratat e drejtuesve të shkollës dhe të autoriteteve ushtarake të vilajetit. "Disa nacionalistë grekë dhe shqiptarë dihet që kanë dalë nga kjo shkollë" - vëren studiuesi Orhan Koloğlu.

Gjimnazi i Janinës "Zosimea" u bë gjatë Lëvizjes së Tanzimatit përherë e më i pëlqyer, shkroi⁽⁹⁾ Eqrem Vlora, dhe deri në vitin 1860, ai ishte një institucion mësimor i kënaqshëm sipas kriterëve të Europës së përparuar, ku mësuan shumë shqiptarë ortodokë dhe muslimanë. "Nxënësit e saj vërtet sillnin me vete në shtëpi një simpati për Greqinë, por ata dilnin prej saj si shqiptarë me ndërgjegje të lartë kombëtare. Të tillë ishin Naim, Sami dhe Abdyl Frashëri, Ismail, Qemali Vlora, Abedin Dino, Gjergj Çako, Turhan pasha etj.

Disa nga këta shqiptarë patriotë themeluan në Athinë qendrën e parë të gjuhësisë shqiptare 1874-1880" - shkrua ai. Por gjithësesi gjuhën shqipe nuk ia dolën ta përdornin në shtypin e kohës në një faqe të veçantë si gjuhë e dytë rajonale, gjë që ia arritën ta bënin grekët, serbët dhe kombësitë e tjera.

GAZETA "ISKODRA" RIDEL NË DRITË (1879)

Lajmin mbi përpjekjet për ribotimin⁽¹⁰⁾ e gazetës "Iskodra" e dha gazeta **Sabah** dhe disa gazeta të tjera në mars 1876. Sipas njoftimeve, njëren faqe ajo do ta kishte në gjuhën osmane dhe tjetrën në italisht. Autori i këtij artikulli, që mendohet të ketë qenë vetë Sami Frashëri shkruante⁽¹¹⁾ se, "...gjuha amtare e gjithë popullsisë së Shkodrës dhe rrethëve të saj dhe e shumicës së popullsisë muslimane ishte shqipja, të cilën ata e shkruanin dhe e lexonin me shkronja latine, madje edhe letërkëmbimin midis tyre ata e mbanin në shqip".

"Mendojmë se do t'i sillte më tepër dobi qëllimit të një gazete zyrtare, nëse njëra faqe e saj, në vend që të botohej në një gjuhë të huaj, të shkruhej në gjuhën amtare të popullsisë. Kështu do të kishte më shumë ndikim në popullsinë e atyre viseve" - theksonte artikullshkruesi. Por gazeta në fakt doli në dritë vetëm pas dy vjetësh e gjysmë.

Vilajeti i Shkodrës ribotoi nga 24 qershor 1879 gazetën e vet⁽¹²⁾ zyrtare "Iskodra". Ajo doli për dy vjet një herë në javë, çdo të enjte, në osmanisht e shqip me alfabet arab, e drejtuar nga Hysen pasha.

Më 27 qershor 1879, në valën e lëvizjes shqiptare të udhëhequr nga Lidhja e Prizrenit, konsulli i Austro-Hungarisë në Shkodër, Friedrich Lippich von Lindburg, e njoftoi⁽¹³⁾ Ministrinë e Jashtme në Vienë se më 24 qershor 1879 kishte dalë gazeta "Iskodra" në shqip dhe turqisht. Sipas tij, lëndën e gazetës e përgatitnin nëpunësit qeveritarë të qytetit dhe lajmet për pjesën shqipe i nxirrnin nga gazetet europiane. Sipas tij, gazeta ndodhet nën ndikimin e valiut të Shkodrës Hysen pasha. Qysh në numrin e parë, njoftonte konsulli, ajo shkroi për Bosnjen e pushtuar nga monarkia dualiste (Austro-Hungaria) një vit më parë dhe bënte kritikë kundër Austro-Hungarisë. Ky lajm i shkurtër u botua⁽¹⁴⁾ edhe në revistën **Leka** të Shkodrës.

Po ashtu Zef Skiroi shkroi⁽¹⁵⁾ në veprën e tij "Shqiptarët dhe çështja ballkanike" mbi ngjarjet e Shkodrës prill - maj 1880: "Ditën e 7 majit 1880 në gazetën zyrtare "Iskodra", e cila shihte dritën për të parën herë në shqip dhe osmanisht, u botua një thirrje e nënshkruar nga Ali Pashë (Gucia), Hodo Beg (Sokoli), Preng Bib Doda, Myftiu Hafiz Efendi (Hafiz Daut Borçiq), Arqipeshkvi Karlo Poten dhe Kol Çoba në emër të parisë e të popullit, në të cilën thuhej se, "... meqenëse Shqipëria pushoi së qeni në sundimin e sultanit, të gjithë nëpunësit joshqiptarë do të pushoheshin nga puna dhe do të detyroheshin të linin vendin dhe se tani e tutje populli nuk do t'i bindej më askujt, përveçse urdherave të Lidhjes dhe këshillave të pleqësisë së fiseve, të cilat do të vazhdonin të ishin ashtu si deri atëherë, të vetmit ligjëvënës

...nga numri i shkruar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht i mirë por me pak probleme. Redaktori zgjodhi si temë kryesore një shkrim të dikurshëm të Baron Nopçës, ku ai për interesat e veta merret mes të tjerash edhe me uljen e figurës së Ismail Qemalit. E quan spiun, ndërsa mundohet që ta përflasë sa më shumë figurën, që duhet thënë se nga fati i jetës së Shkëlqesisë së tij, rezulton krejt ndryshe. Plaku do të vdiste në kushte të tmerrshme dhe me pretendimin se u helmua. Nëse do kishte bërë shërbimet që mëton Nopça ai atëherë do kishte të paktën fund më të mirë. Nopça ka një kontribut të madh për albanologjinë por edhe gjeologjinë dhe gjeografinë tonë kombëtare. Mbaset për hir të këtyre e gjithë lufta për pushtet që bëri dhe shpresa donkishoteske për fronin e vendit tonë i falet. Redaktori u mundua ta sqarojë vetë këtë rebus, por duke bërë një tekst me një titull disi provokativ për të ngacmuar kureshtjen e lexuesit. Autori botoi një shkrim të zotit Fotaq Andrea, që ishte konceptuar si epistolar. Duhet të theksojmë se ai është botuar në vend tjetër dhe redaktorit i erdhi keq, që autori nuk e kishte vënë me dije. Ndërkohë autori na bëri një vërejtje teknike, lidhur me shkrimin, të cilin në rastin konkret e vlerësojmë,

pasi realisht ka mospërputhje të titullit me citimin që i kemi bërë autorit...Autori mëton që ky është imazhi i parë zyrtar i Skënderbeut. Pas tre javësh u mbyll novela e Kujtim Dashed: *Pas Guttenbergut një filxhan çaj me kamomil*. Kjo pjesë pretendonte të kishte shumë lidhje me kohën e sotme...dhe autori e kishte zgjidhur me humorin e tij të zakonshëm. Redaktori shkroi diçka dhe për miqtë e tij të ekspozitës "Nëntori", duke e vlerësuar kontributin e madh të tyre dhe jo vetëm. *Vështirësitë, puna e madhe për të gjetur mjedise e duhura për të ekspozuar, por edhe elementët e tjerë e bëjnë ekspozitën të mos ketë më shumë se 25-30 artistë. Njerëzit që merren me të i kushtohen me të gjitha mjetet por edhe me angazhime që e tejkalojnë shpreh mundësitë e tyre. Ndaj, "Nëntori", mbetet një stoli e bukur dinjiteti për qytetin tonë, por edhe mësim për traditën dhe mbi të gjitha vazhdimësinë. Pikërisht, qoftë edhe për këtë element të fundit, ata meritojnë një duartrokitje të plotë dhe nderim, shkroi ai, duke marrë shkas dhe nga punët e tyre të këtij edicioni. Në përgjithësi, mund të themi se ishte një numër i mirë, por redaktori duhet të ishte më i kujdesshëm me imazhin.*

të shtetit të ri".
Në vitin e dytë të jetës së saj, më 1880 botuesit e saj deklaruan haptazi se, gazeta ishte "organ i degës së Lidhjes së Prizrenit në Shkodër". Ky pohim do të shënoente edhe mbylljen e këtij organi fill pas shtypjes dhe shpërndarjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
Në vitet që pasuan pasi Lidhja Shqiptare e Prizrenit pushoi së ekzistuari gazeta vazhdoi të botohej jorregullisht vetëm në osmanisht. Gazeta u prodhuan në shtypshkronjën e Shkodrës përballë pallatit qeveritar të qytetit.
Studiuesit pohojnë se pas mbylljes më 1880, gazeta "Iskodra" ridoli në dritë edhe në 1897 deri në 1903, por këtë botim të tretë të saj, ende ka pak të dhëna.

(Marrë nga numri i ri i revistës kulturore "Univers", e sapodalë nga shtyp, nr.19)

- Shënime
1. Kastrioti, Jup. *Bibliografi shqipe e dramatikë - narrativës dhe shqipërisë (1730-1946)*. Kapitulli i fundit është "Bibliografia e shtypit (1946-1949)". Gjendet edhe në Balu, Beqzad. *Vepra bibliografike e prof. Jup Kastriotit*, Prishtinë, 2001, f. 47. Vepra e hartuar në vitet 1942-1946 ruhet në dorëshkrimin origjinal në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë. Edhe pse e gatshme dikada më parë, ajo nuk u botua nga regjimi komunist për arsye politike, siç dëshmon dr. Hamit Borçiq. Ky dorëshkrim i shtypësia nga pothuaj të gjithë studiuesit e kësaj fushe për 25 vjet, deri në 1971, kur Palok Daka nisi të botojë *Bibliografinë retrospektive e shtypit periodik shqiptar e Pallatit Dakës*. (Shih: H. Borçiq, *Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptarë 1948-1997*, Tiranë 1997, f. 25. Një bibliografi më të plotë me qindra tituj të rinj e ka qat bibliografi tjetër Maksim Gjinaj. Të treja këto bibliografi të shtypit shqiptar; Kastrioti, Daka dhe Gjinaj janë ende të shtypura.
 2. Daka, Palok. *Bibliografia retrospektive e shtypit shqiptar dhe mbi Shqipërinë e viteve 1848-1944*. Botuar në revistën *Studime Historike*, viti 1971, nr.3, f.139-170, nr.4, f.185-226, vit 1972, nr.1, f.185-212, nr.2, 205-224, nr.3, f.229-254, vit 1973, nr.1, f.185-202, nr.2, f.191-204, nr.3, 205-224, nr.4, f.202-222, vit 1974, nr.1, f.208-224. Mbledhur në një vëllim nga Biblioteka Kombëtare, Faqe 8.
 3. Tami, Çihat. "arki Rumeli Türkerinin sesi Emniyet Gazetesi (1886-1887). The voice of East Rumelian Turks the newspaper of Emniyet (1886-1887). Konya 2011, Faqe IX.
 4. Ceylan, Ayhan. *Tanzimat Dönemi Osmanlı Basını ve Yayınında Hukuki Düzen (1839-1876)*. *Türk Hukuk Tarihi Araştırmaları*, S. I. İstanbul 2006, faqe 139-155.
 5. Tarrari, Alban. *Mediat turkofone në Ballkan*. Tiranë, 2015, faqe 38-39.
 6. Gençoğlu, Mustafa. *Yshkodra Vilayeti'nin Ydari Taksimatı ve Yayıncılığı (1867-1889-1909)*. (Ndarja administrative dhe territoriale i Vilajetit të Shkodrës). *CIB Social Bilimler Dergisi - CIBI University of Social and Journal Sciences*, Volume: 13, Issue: 3, September 2015, Faqe 259-290.
 7. Girgin, Atilla. *Türk Basını Tarihi'nde Yereel Gazetecilik*. Ystanbul, 2001. Faqe 86-87. Sipas tij, dolen nga viti 1860 në Beyrut gazeta *Had-İhtilal* / *Ahhar* (turqisht-arabisht), 1865 në Tama - gazeta *Tama* (turqisht-bullgarisht), 1865 në'am / *Sarıyay* (turqisht-arabisht), 1866 në Trabushgarb / *Trabushgarb* (turqisht-arabisht), 1867 në Halep / *Gadire* / *Firat* (turqisht-arabisht), 1867 në Cebel Lüban / *Lüban* (turqisht-arabisht), 1867 në Kreta / *Girit* (turqisht-greqisht), 1868 në Edirne / *Edirne* (turqisht-greqisht), 1868 në Shkodër gazeta *Iskodra* (turqisht), 1868 në Janinë / *Yanya* (turqisht-greqisht), 1869 në Bursa / *Hüdavendigâr* (turke-berberisht), 1869 në Halep / *Firat* (turqisht-arabisht), 1869 në Konya / *Konya* (turqisht-greqisht), 1869 në Trabzon / *Trabzon* (turqisht-greqisht), 1869 në Bagdat / *Zeyra* (turqisht-arabisht), 1871 në Prizren gazeta *Prizren* (turqisht-greqisht), 1872 në Kastamonu / *Kastamonu* (turqisht), 1872 në Adana / *Seyhan* (turqisht-greqisht), 1872 në Yemen / *Yemen* (turqisht-arabisht), 1873 në Manastir / *Rumeli* (turqisht), 1874 në Ankara / *Ankara* (turqisht), 1876 në Herzegovina / *Neretva* (turqisht-serbisht), 1877 në Prishtinë gazeta *Kosova* (turqisht-serbisht), 1877 në San'a / *San'a* (turqisht-arabisht), 1878 në Sivas / *Sivas* (turqisht), 1884 në Manastir / *Manastir* (turqisht), 1884 në Musul / *Musul* (turqisht), 1903 në Kadüs / *Kadüs* (turqisht-arabisht), 8. Topuz, Hıfzî. *II Mahmut'un Holdingleri Türk Basını Tarihi*. (Nga Mahmuti I Dytë deri të Holding-ët, Historia e Shtypit Turq). Stamboll, 2003. Faqe 33-34.
 9. Kolođub, Orhan. *Osmanlı'dan 21. Yüzyıla Basını Tarihi*. (Historia e Shtypit nga Osmanllinjët deri në shekullin e 21-të). Stamboll, 2006. Faqe 35.
 10. Vllora, Egrem bej. *Kujtime*. Vëllimi i parë 1885 - 1912. Tiranë 2001, Faqe 169-171.
 11. Lajmet nga vilajetet. *Sabah*, nr.17, 14 (26) mars 1876, faqe 2. (Prifti, Kristaq, Buharaja, Vehchi, Zedhenesi i Lindjes, Sami Frashëri. *Vepra* 14, Prishtinë e Shkup, 2004, faqe 165.
 12. Studiuesit shqiptarë mendojnë se ky autor është Sami Frashëri.
 13. Daka, Palok. *Bibliografia retrospektive...*, faqe 8. Marrë nga Leka. *Shkodër*, 1939, nr.9-12, faqe 286.
 14. Frashëri, Kristo. *Në gjurmë të dy gazetave të vjetra shqipe Zeri i Popullit*, 22 nëntor 1962, faqe 3 dhe në *Tribuna e Gazetarit*, nr. 3-4, 1967, faqe 13-14.
 15. Leka, Shkodër. Nr. 6 - 12, 1939, faqe 286.
 16. Schiro, Giuseppe. *Gli Albanesi e la questione balcanica* Napoli 1904, faqe 64.

E
EKSPOZITA

Për hir të së vërtetës, "Nëntori-2018" e ka gjetur gjuhën e tij dhe ka krijuar fizionominë, duke bërë që ata të cilët e mënjanojnë duhet të kenë parasysh se ky grupin, që rinovohet për çdo vit ka dhënë mesazhe shumë interesante, ku në mes është njeriu, problematikat e homos albanicus në shekullin tonë. Paçka se moshat përfaqësuese shkojnë nga 20 deri afër 90, shqetësim është i njëjtë: Fati i vendit, i shqiptarit dhe vazhdimisht kërkimi në koncept dhe mjete shprehëse...

Nëntori, një aromë e bukur civile nga piktura

NGA BEN ANDONI

Edicioni i sivjetmë i "Nëntori 2018" është dukur se ka ikur sërish i pavërejtur nga kritika shqiptare e arteve pamore. Kurse burokratët e Ministrisë së Kulturës në hallakat e tyre patetike se kanë parë të arsyeshme t'u japin një dorë. Të paktën t'i lironin nga shpenzimet bazë.

Duhet të sqarojmë se artistët e këtij grupimi, falë këtij lloj bllokimi që i bëjnë, kolegët e tyre, instancat zyrtare u ka shërbyer të mbrothrin fatin e tyre dhe të jenë gjithnjë e më të bashkuar. Ndërsa mesazhet e tyre janë realisht shqetësime që ia vlen të diskutohen dhe jo vetëm.

Ksenofon Dilo, Zef Shoshi, Llazar Taçi me krijimet e tyre, ku peizazhi artistik tregon një përfaqje tjetër të realitetit por tregon sërish një evolim të tyre. Zef Shoshi, p.sh. vitin e Skënderbeut e ka zgjidhur me kompozimin e një gjame burrash para Skënderbeut të ramë, pak larg ornamenteve të tij klasike. Kurse Llazar Taçi e përdor deri në intësi përshkrimin e kryeheroit duke dhënë realisht një frymë të këndshme të figurës së tij.



Besim Tula, me stilin e tij karakteristik, ka bërë një gjetje të këndshme brenda dipiktur, ku sfondin e një familje refugjatësh e mbush me një rozë shpresë dhe në kompozicion i vë sipër njëri-tjetrit në ëndërrën e tyre të së ardhmes.

Për hir të së vërtetës, "Nëntori-2018" e ka gjetur gjuhën e tij dhe ka krijuar fizionominë, duke bërë që ata të cilët e mënjanojnë duhet të kenë parasysh se ky grupin, që rinovohet për çdo vit ka dhënë mesazhe shumë interesante, ku në mes është njeriu, problematikat e homos albanicus në shekullin tonë. Paçka se moshat përfaqësuese shkojnë nga 20 deri afër 90, shqetësim është i njëjtë: Fati i vendit, i shqiptarit dhe vazhdimisht kërkimi në koncept dhe mjete shprehëse.

Duhet të inkurajohet veçanërisht një njeri, që e mban frymën e këtij aktiviteti dhe që prej vitesh është boshti i tij. Kuratori Besim Tula është jo thjesht njeriu që inonin, grumbullon, organizon, por përmes mesazheve të tij përcjell atë që artistët i paraprijnë gati të veçuar në laboratorët e tyre të krijimit.

Merita Selimi një autore që kurrë nuk e ka braktisur pasionin e saj me lapsin ka bërë një gjë të mrekullueshme, pasi ka stilizuar një motiv të "Refugjatëve" të Buzës, që shkuese e kap me vështirësi në një cep të punës së saj. Kjo pikturë duhet vlerësuar për frymën, por edhe realizimet aspak të lehta me teknikën e lapsit.

Shqetësimin që e shikon të brezi i ri të duket pak më i kursyer dhe i drejtuar në aspekte të tjera që transformohen disi pak më të gëzuara të brezi i vjetër i piktorëve, në një farë përpjekje të këtyre të fundit, që duan ta lehtësojnë këtë brengje krijuese.

Gazmend Leka të përthith me universin e tij dhe mënyrën e komunikimit intelektual që zgjedh përmes artit të tij. Në ekspozimin e fundit, ai ka nxjerrë një punë tjetër veç "Lutjes", në të cilën tashmë kemi një mjedis, në të cilin paraprihet gjendja jonë.

Artan Buca bën një dipikt me një mesazh të qartë për natyrën dhe mjedisin e kohës sonë, një subjekt që e shikon edhe më herët në punët e tij. Ngushtimi i diapazonit bën të dallosh me këtë rast edhe ngushtimin e burimeve natyrore, që do të thotë mënyra sesi ne po e administrojmë natyrën tonë.



A

ARGUMENT

Duhet bërë çmos për të bashkuar gjithë shqiptarët dhe përforcuar dinjitetin e Shqipërisë me çdo kusht, pavarësisht nga përçarjet e mëparshme dhe kusuret që kemi mbartur. A nuk ishte ky pikësynimi i Mithat Frashërit? Si askush tjetër këtë gjë ka bërë dhe vazhdon të bëjë Ismail Kadare me letërsinë dhe veprimtarinë e tij. Nuk besoj se Mithat Frashëri ngrihet me lart duke ulur Ismail Kadarenë...

Mithat Frashëri dhe Ismail Kadare për kombin shqiptar: Nga një veprimtar në tjetrin

NGA ALBERT DOJA*

Këto ditë fund-tetori dhe fillim-nentori, me rastin e pushimeve shkollore të ndërmjetme, u ndodha në Tiranë dhe pata mundësi të përjetoj një sërë aktivitetesh të qytetit por edhe një sërë poteshesh që shumëkujt mund t'i duken të zakonshme në qytet. Mes tyre një ceremoni përuruese për botimin e vëllimit të tretë të veprave të zgjedhura të Mithat Frashërit me parathënien nga Ismail Kadare ka ngjallur një zallahi të poteshme në portale dhe mediat sociale. Edhe një ekonomist i diasporës shqiptare ka shkruar një status të gjatë të mbushur me lavdërime pa masë për njerin dhe fyerje pa fre për tjetrin, me kërkesën ndaj ketij të fundit për t'i kërkuar falje të parit për krimet e komunizmit. Meqë kam patur rast ta njoh vite shkuara në një tubim akademik ndërkom-bëtar ndërhyra në statusin e tij duke besuar se mund t'i kërkoja të mbante një "mendim më të balancuar" lidhur me këto dy figura të mëdha të kombit shqiptar.

Me një përgjigje të gjatë në formë letrë të hapur dhe të datuar, që përshkohej fund e krye përsëri nga e njëjta gjuhë sharjesh e lavdërimesh panagjerike në adresë të njërit apo të tjetrit protagonist, ai më kujtoi fletërrufet apo daxibaot e kohës së shkruar kur për çdo hap që bëja goditesha nga ihtarët e komunizmit dhe kur më duhej të jepja llogari në mbledhjet e kolektivit apo në zyrat e sigurimit. Ihtarët e komunizmit nuk kishin hallin tim por hallin e tyre, kush e kush të dukej sa më i perkushtar ndaj çështjes së Partisë. Për këtë ata merrnin shpërblime të shumta, disa nga kolegët e mij edhe specializime jashtë shtetit. Por me sa duket komunizmi paska rrënjë të thella, perderisa u paska lënë disave për kusur të vazhdojnë luftën e klasave me çdo kusht.

Pa dyshim që të gjithë pajtohemi në një pikë të përbashkët kur gjithkush kërkon denimin e komunizmit dhe drejtësi për viktimat e tij, jo vetëm "si slogani pa shumë përmbytje" siç aludohet edhe ndaj meje në rrjedhën e akuzave ndaj Ismail Kadaresë. Ligji i lustracionit për denimin e krimeve të komunizmit është gjëja e parë që duhet të ishte bërë në Shqipëri më shumë se kudo.

Por nuk e kam zakan të merrem me letra të hapura e daxibaot të ketij lloji. Kush të dojë të mesojë më shumë se si e kam dënuar komunizmin, në fushën modeste të kompetencave të mia, le të gjykojë më mirë nga punët e mia të botuara ku kam bërë sa kam mundur për të demaskuar "krimet" e studimeve të kohës së komunizmit ku përshihen si studimet albanologjike edhe letërsia e realizmit socialist. (Shih p.sh. Albert Doja & Enika Abazi (2016) "From the communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism", *Communist and Post-Communist Studies*, vol. 49 (2), pp. 163-178, <http://dx.doi.org/10.1016/j.postcomstud.2016.04.002>, Open access <https://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-01309745>; shih edhe Albert Doja (2015) "From the native point of view: An insider/outsider perspective on folkloric archaism and modern anthropology in Albania", *History of the Human Sciences*, vol. 28 (4), 2015,



pp. 44-75, <http://dx.doi.org/10.1177/0952695115594099>, Open access <https://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-01214230>).

Megjithatë, me kritikën time qëllimi nuk është vetëm të denoj "krimet" apo të rivendos drejtësitë. Punën time e shoh si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për të shtruar themele më të forta që t'i shërbejnë bashkimit dhe forcimit të kombit shqiptar. Madje edhe për vlerësimin e Frashërlinjve në punimet e mia, gjithnjë brenda fushës së kompetencave të mia, une nuk kam treguar aspak afinitetin fetar të Naim Frashërit, por përdorimin e fesë nga Naim Frashëri për të bashkuar kombin shqiptar, duke përfunduar se për këtë nuk ka nevojë që Naim Frashëri të shikohet si i lidhur me fenë, si bëjnë disa dhe që nuk ka sjellë veçse përçarje. (Shih p.sh. Albert Doja (2013) "The Politics of Religious Dualism: Naim Frashëri and his elective affinity to religion in the course of 19th-century Albanian activism", *Social Compass: International Review of Sociology of Religion*, vol. 60 (1), pp. 115-133, <http://dx.doi.org/10.1177/0037768612471770>, Open access <https://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-00806371>; shih edhe Albert Doja & Enika Abazi (2013) "Further considerations on the politics of religious discourse: Naim Frashëri and his Pantheism in the course of nineteenth-century Albanian nationalism", *Middle Eastern Studies*, vol. 49 (6), pp. 859-879, <http://dx.doi.org/10.1080/00263206.2013.836495>, Open access

[ouvertes.fr/halshs-00922488](https://halshs-00922488)).

Në fund të fundit, me përjashtim të ndryshimit të regjimeve tek të cilët si Mithat Frashëri edhe Ismail Kadare janë mbështetur nuk ka ndonjë ndryshim të madh mes njeri-tjetrit për njerëz të tillë të mëdhenj të kombit shqiptar. Për mua, pavarësisht nga kusuret e veta dhe peripetitë e historive të tyre, këta janë dy kollosë të mëdhenj që meritojnë njëllor respektin e kombit dhe përlulësinë e bashkëkombasve të tyre. Mithat Frashëri u përpoq për bashkimin e kombit, ashtu si Ismail Kadare është përpjekur dhe përpigjet për dinjitetin e kombit. Megjithatë, nëse Mithat Frashëri u mbështet tek fashizmi njëllor si Ismail Kadare u mbështet tek komunizmi, deri këtu nuk ka asnjë ndryshim. Ndryshimi qëndron tek në që kujtojmë se mbështesim Shqipërinë duke përballuar njerin apo tjetrin prej tyre dhe kështu duke përçarë bashkëkombasit.

Sa për kuriozitet, lidhur me rolin e Mithat Frashërit në dëshitim apo suksesin e Kongresit të Manastirit, mund të shihet një burim që nuk ka lidhje me manipulimet komuniste, si p.sh. Frances Trix (1997) "Alphabet conflict in the Balkans: Albanian and the Congress of Manastir", *International Journal of the Sociology of Language*, vol. 128, pp. 1-23. Ndërsa për provat e bashkëpunimit të Mithat Frashërit me pushtuesit, kjo është një çështje historike jash-

të kompetencave të mia. Sigurisht ka punime të mira të cilave mund t'u referohet gjithkush, si p.sh. Ana Lalaj me literaturën dhe dokumentacionin e përdorur prej saj, ndonëse studiuesit shqiptarë duhet patjetër të merren edhe më shumë me këtë çështje.

Unë nuk jam historian që të shkruaj apo rishkruaj historinë. Ashtu si në shkencat ekonomike që besoj se të tjerët i njohin më mirë se unë, edhe shkencat e tjera sociale merren me analizën e realitetit ekonomik, social, politik apo historik. Por çdo lloj nga këto analiza nisen para së gjithash nga hamendësimet dhe hipotezat që çojnë përpara shpjegimin ekonomik, sociologjik, politik apo historik. Prandaj e vetmja gjë që mund të bëjë është një analizë e këtij lloji dhe e pa-anshme.

Me dy fjale, si Balli Kombëtar edhe komunistat shqiptarë janë përpjekur të bashkojnë shqiptarët nën flamurin e tyre dhe të marrin pushtetin. Për fat të keq, apo ndoshta pikërisht për këtë arsye, Balli Kombëtar dhe komunistat shqiptarë u rreshtuan në llogoret e kundërta të luftës civile. Por si njëra pale edhe tjetra u mbështetën tek fuqitë e mëdha ndërluftuese, njëra palë me fuqitë e boshtit fashist dhe pala tjetër me fuqitë aleate antifashiste. Komunistat shqiptarë u mbështetën tek Bashkimi Sovjetik ndërsa Balli Kombëtar mund të mos ketë bashkëpunuar drejt-përsëdrejti por u gjend në të njëjtën llogore me Gjermaninë Naziste.

Gjatë luftës, si Komunistat edhe Balli kanë patur qëllimet e tyre politike dhe kanë luftuar me të gjitha mjetet për t'i realizuar ato. Por edhe Sovjetikët dhe Gjermanët, si dhe bashkëpunëtorët e tyre, kanë patur qëllimet e tyre politiko-ushtarake dhe kanë bërë çmos për t'i realizuar ato. Në politikën e tyre ata përshinë edhe manipulimin e aspiratave etnike (në rastin e gjermanëve) apo revolucionare (në rastin e sovjetikëve) të popujve të pushtuar. Deri këtu mund të thuhet se nuk ka asnjë problem. Në fund të fund edhe sot ne kerkojmë mbështetje tek partnerët amerikanë apo gjermanë. Çështja qëndron vetëm në faktin se Luftën e Dytë Botërore e fitoi Bashkimi Sovjetik ndërsa Gjermania Naziste kapitulloi, pra historia ka nxjerrë fitimtar njërin palë në dëm të tjetrit. Ky ishte fati historik që nuk ndryshohet dot. Gjithçka tjetër mbetet çështje bindjesh e besimesh. Nese nisemi nga pozita të një-anshme futemi në qorrakun e bindjeve dhe besimit. Por me bindjet dhe besimin nuk mund të argumentohet.

Një shembull i thjeshtë larg potereve shqiptare mund të shërbejë për ta kuptuar më mirë këtë analizë. Në Francë, Marechal Petain ka qënë dhe mbetet heroi fitimtar i Luftës së Parë Botërore. Perkujtimet zyrtare të njëjnd-vjetorit të kësaj fitoreje kanë filluar pikërisht këto dite. Por gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai bëri kompromis kombëtar me Gjermaninë Naziste për të shpëtuar Francën nga pushtimi dhe Parisin nga shkatërrimi. Për këtë Franca e denoi me burgim të përjetshëm. Edhe sot e kësaj dite, Franca e konsideron si një turp kombëtar. Megjithatë, në varrin e tij vazhdojnë homazhet nga disa që janë të bindur dhe besojnë se ai mbetet heroi fitimtar i Luftës së Parë Botërore që i dha nder e lavdi kombit francez, pa çka se e mbuloi me turp gjatë Luftës së Dytë. Askush nuk mund të argumentojë me bindje dhe besimin e tyre.

Krahasieme të tilla që përdoren në këto lloj analizash mund të cilësohen me naivitet si konkluzione të mëdha që thuhet se "huazojnë gjëra të sajara... ashtu kulturë". Por mund të them se as Franca, as Shqipëria dhe askush nuk mund të ketë një histori të faktuar e të pranuar gjërësisht siç besojnë disa. Madje më duket një shprehje e kompleksit të inferioritetit kombëtar nëse besojmë se vetëm ne si komb apo vetëm komunistat shqiptarë kanë qënë aq të "mençur" sa të manipulojnë historinë, ndërsa të tjerët nuk e kanë këtë aftësi. Shprehje e të njëjtit kompleks inferioriteti është edhe besimi se me, Shqipëria, kombi shqiptar, traditat apo historia shqiptare, ku përshihet edhe diktatura komuniste, përbejnë një rast unik që duhet trajtuar në mënyrë të veçantë në analizat historike.

Kudo qofshin, njerëzit do ta interpretojnë dhe do ta nderojnë historinë duke u mbështetur në bindjet dhe besimet e tyre që mund të jenë shumë të lavdëruara por nuk janë argumente mbi analiza historike. Askush, as historianët më të shquar nuk shpëtojnë dot

nga manipulimi, demagogjia dhe shtrembërimet dashakeqese apo dashamirëse të historisë. Prandaj sa herë janë ndërruar regjimet ideologjike historia është rishikuar dhe do të rishikohet meoemos, si në Shqipëri edhe në Francë dhe kudo.

Këtë kam parasysh dhe nuk aludoj për "axhenda të errëta" kur them se nuk e di kujt "partie" i shërbejnë këto daxibaoë e sotme për të lartësuar apo përdhosur dikë me çdo kusht, por jam i sigurt se i shërbejnë më së miri dikujt apo një kauze të caktuar. Nuk ka, nuk ka pasur dhe nuk do të ketë asnjëherë dhe asgjëkundi një histori objektive. Sepse historia shkruhet gjithnjë për dikë dhe ka gjithnjë një qëllim të caktuar ideologjik. Edhe fakti që ne sot kërkojmë mbështetje tek partnerët amerikanë apo gjermanë do të vlerësohet e rivlerësohet përsëri nga historia në të ardhmen. Kësaj nuk i shpëtojmë dot me bindjet e tanishme dhe besimin e patundur që mund të kemi se po e bëjmë në të mirën e kombit.

Në fakt, siç ka vënë në dukje një nga mendjet më të ndritura por edhe më kritike të njerezimit dhe që ekonomistat e njohin shumë mirë, çështja është se historinë e shkruajnë fitimtarët. Vërtet komunizmi është përmbysur në Shqipëri por vlerat kulturore dhe historike mbi të cilat mbështet regjimi i sotem rrjedhin përsëri nga fitorja e demokracive liberale mbi fashizmin. Prandaj nëse komunizmi sovjetik e shqiptar u rreshtua me demokracitë liberale dhe balli kombëtar u mbështet tek Gjermania Naziste si fuqia më e rëndësishme e boshtit fashist, historia e Mithat Frashërit mbaron këtu.

Sigurisht, konkluzionet historike do të ishin "krejt të pabaza" nëse i faturojmë Mithat Frashërit qëllimin "në një llogore" me palën humbëse vetëm e vetëm se komunistët fituan pushtetin. Në fakt është e kundërta, Mithat Frashëri i faturohet fati i keq historik, të cilin propaganda komuniste e ka cilesuar si tradhëti, jo meqë komunistët fituan pushtetin, por meqë Balli Kombëtar u gjend "në një llogore" me palën humbëse, domethene me fuqitë e boshtit fashist kundër të cilave fituan fuqitë aleate antifashiste ku u rreshtuan edhe komunistat shqiptare.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Mithat Frashëri nuk ka merita dhe nuk duhet vlerësuar si veprimtar i madh i kombit shqiptar. Përkundrazi, na duhet të vlerësojmë tek ai dhe tek çdokush tjetër çdo lloj përpjekje që i ka shërbyer çështjes kombëtare.

Për fat të mirë, si askush tjetër, Ismail Kadare u ka dhënë dinjitet ndërkomëtar letrave shqipe dhe gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen. Por kjo nuk u intereson shumë kundërshtarëve të tij që merren me shumë me biografinë e tij personale dhe politike. Shumëkush thotë se gjatë regjimit komunist ai ishte një farë shkrimtar oborri dhe shumëkush mund të thotë se nuk mund të ishte ndryshe sepse ashtu ishte koha. Megjithatë, kundërshtarët e tij përpara se ta përgojojnë e ta përbalnin do të bënin më mirë të lexonin veprat e tij në kontekstin politik të kohës kur janë shkruar e janë botuar.

Në fakt, në atë kohë të gjithë fshiheshin në brima si minj dhe ne të rinjve na dukej sikur bënim disidencë me zullumet shkollore vetëm e vetëm për t'u bërë sherr trupit mësimdhënës që kishte detyrën të na disiplinonte me hapin ushtarak të Partisë. Ata që më kanë njohur gjatë viteve shkollore me siguri kujtojnë se kur na bëhej zbor me këngë partizane, "disidencën" me e madhe ishte që ne vend të tyre të këndonim këngët patriotike të Rilindjes dhe të lëvizjes për pavarësi kombëtare. Kjo duket sa qesharake apo naive aq edhe për të ardhur keq. Por tregon gjendjen e pashpresë në të cilën ndodheshim në të rinjtë. Në një kohë të tillë, vetëm tek Ismail Kadare mund t'i kthenim sytë dhe veshët për sadopak shpresë. Ai e dinte këtë dhe nuk na ka zhgënjyer.

"Keshjtjella" e tij, për shembull, na ka mbushur me ngazellim, sepse për ne "Keshjtjella" nuk ishte qëndresa ndaj imperializmit por qëndresa e kombit ndaj komunizmit aziatik. Ndërsa kur doli "Pallati i ëndrrave", kjo nuk ishte më sekret për askend. E kemi pritur me brohoritje nga shpirti. Madje një gjurë bashkëmoshatarësh jemi mbledhur sëbashku dhe kemi festuar në shoqëri të fshtë se ne na duket sikur vetëm ne zotëronim çelësin e një të vërtete të madhe që parashikonte kalëzimin dhe frymëzonte për shkërrimin e komunizmit. Në fakt, mund të them se me "Pallatin e ëndrrave" të Ismail

Kadarese, komunizmi mori goditjen e parë në mendjet e shqiptarëve, prej nga mori edhe kthesën drejt fundit të vet. Kjo është magjia e letërsisë së madhe, si dhe fuqia e madhe e një gjeniu si Ismail Kadare. Kjo nuk duhet harruar dhe aq më pak të përbuzet, por duhet promovuar.

Në fund të fundit, jo më kot Ismail Kadare ka fituar famë botërore, jo tani dhe as si disident i vetëshpallur, por në kohë më të vështira të Luftës së Ftohtë, sepse Perëndimi shihte tek ai një disident të mundshëm që me shumë gjasa mund të frymëzonte popullin e tij për rrëzimin e komunizmit. Por më shumë se çdo gjë tjetër, Ismail Kadare duhet vlerësuar e perkrahur, jo sepse nuk ka kusure personale, por sepse ai ka shfrytëzuar famën që ka fituar në botë për t'u bërë sot si askush tjetër korifeu më i madh i veprimtarisë kombëtare, që si një simbol kombëtar lufton për ta bashkuar dhe për t'i dhënë emër e dinjitet kombit shqiptar.

Ç'është e vërteta unë revoltohem kur përbaltem figurat e shquara të kombit, sidomos ata që janë bërë simbole kombëtare, ashtu si gjuha dhe flamuri, me fjalë të tjera ata që i kanë dhënë emër e dinjitet kombit shqiptar. Revoltohem kur disa shkojnë gjer aty sa të përbaltem edhe Skënderbeun dhe me vjen mirë kur Ismail Kadare i bën homazh Mithat Frashërit. Kjo nuk është hipokrizi por përpjekje për të bashkuar e përfurcuar kombin shqiptar. Më vjen mirë sidomos që këtë gjë e bën pikërisht Ismail Kadare. Edhe pse disa nuk mund ta kuptojnë, në fakt s'ka si të jetë ndryshe. Nëse ruajmë proporcionet përkatëse, vetëm Skënderbeu qëndron pa dyshim para tij për emrin dhe dinjitetin që i ka dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve në botë. Midis Skënderbeut dhe Ismail Kadarese mund të ketë edhe ndonjë tjetër, por kjo nuk ka rëndësi në këtë diskutim. Ismail Kadare nuk është thjesht vetëm një gjeni i letërsisë shqipe. Ai është një nga veprimtarët e fundit që i jep nder, lavdi e dinjitet kombit shqiptar në botë si askush tjetër. Nëse hedhim balë përmbi të, kombit shqiptar nuk i mbetet veçse baltovina. Prandaj kur të flasim për Ismail Kadarenë duhet të mendohemi mirë me kë jemi, me kombin shqiptar apo me baltën ku kemi mbetur dhe që hedhim mbi kokat e njeri-tjetrit.

Duhet bërë çmos për të bashkuar gjithë shqiptarët dhe përfurcuar dinjitetin e Shqipërisë me çdo kusht, pavarësisht nga përçarjet e mëparshme dhe kusuret që kemi mbartur. A nuk ishte ky pikësynimi i Mithat Frashërit? Si askush tjetër këtë gjë ka bërë dhe vazhdon të bëjë Ismail Kadare me letërsinë dhe veprimtarinë e tij. Nuk besoj se Mithat Frashëri ngrihet me lart duke ulur Ismail Kadarenë. Njerëzit e mëdhenj e të dobishëm vlerësohen nga veprat dhe kontributet që kanë për kombin e tyre dhe për mbarë njerëzimin, por edhe që u njihen si të tilla nga të tjerët. Nëse gjithëkush do bënte sadopak në këtë drejtim, Shqipëria do ishte bërë me kohë.

Si përfundim, prandaj kam kërkuar një "mendim më të balancuar" në vlerësimin e këtyre dy figurave kombëtare. Sepse me të tillë si Mithat Frashëri dhe Ismail Kadare duhet të kishim më shumë shpresë. Por me sa shoh, për fat të keq, mundimi i veprimtarëve të tillë si Mithat Frashëri dhe Ismail Kadare ka shkuar dhe po shkon dëm. S'ka mbetur më asnjë Mithat Frashëri ta bashkojë këtë komb dhe nëse përbuzim Ismail Kadarenë nuk do të mbetet asnjë tjetër si ai për t'i dhënë dinjitet këtij kombi. Një shembull i mirë për të punuar për bashkimin dhe përfurcimin e shqiptarëve dhe të Shqipërisë duhet konsideruar homazhi i Ismail Kadarese për Mithat Frashërin. Më lemeris ideja që me këto lloj përçarje dhe përbaltje s'kemi për t'u bashkuar kurrë si komb dhe kemi për t'u mbetur gjithnjë pa dinjitet. Mjerisht shumë shqiptarëve u ka ngelë ora te Mukja dhe te lufta e klasave. Nuk e di kujt i intereson kjo... vaj medet...

Megjithatë, besoj se Mithat Frashëri dhe partizanët e tij të sotëm mund t'i bashkohen Ismail Kadarese si një simbol kombëtar dhe korifeu i padiskutueshëm i veprimtarisë së sotme kombëtare. Vetëm kështu të gjitha forcat dhe pikësynimet kombëtare do të kontribuojnë për ta rreshtuar kombin shqiptar me fitimtarët në betejat e së ardhmes, sepse pa dyshim historinë do ta shkruajnë gjithnjë fitimtarët.

*Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Profesor titullar në Universitetin e Lilës, Francë

Ing. Gjadrit u akordua titulli "Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor" nga Komisioni i Lartë i Atestimit dhe në vitin 1995, dhe në sajë të punës së tij projektuese dhe shkencore, u akordua titulli "Drejtuës Kërkimesh Shkencore". Të dy këto tituj janë tregues të vlerësimit unanimit që ai gëzonte në gjirin e bashkësisë së shkencëtarëve shqiptarë të asaj kohe.

Inxhinier Egon Gjadri: një jetë në shërbim të shkencës shqiptare të ndërtimit

NGAA. MARKU

Jeta dhe veprimtaria e inxhinier Egon Gjadrit është e lidhur ngushtë me projektimin e veprave më të rëndësishme që u realizuan në harkun kohor 1958-1993, nga digat e hidrocentraleve, tunelet hekurudhore dhe automobilistike etj. Egoni ishte djali i vetëm i inxhinierit të mirënjohur shkodran Gjovalin Gjadri, atij që duke u treguar inovatori i parë shqiptar aplikoi teknika të reja në projektimin e urës së Gomsgjes, e cila më vonë u hodh në erë nga ushtria gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Por Gjadri senior, përveçse si projektues, njihet edhe për librin e tij "Letra grues seme të vdekur", që së fundi pa dritën e botimit edhe në gjuhën shqipe.

Si i ri, Egon Gjadri do të aktivizohej si voleybollist me ekipin e Studentit dhe Tiranës, duke bërë pjesë edhe në kombëtaren tonë që do të merrte pjesë në kampionatin evropian të Bukureshtit. Pasi kreu studimet e larta në degën inxhinieri pranë Universitetit të Tiranës, Egoni nisi punën pranë Institutit Nr. 3 të Projektimit, ku punuan ndër vite krijues të apasionuar dhe talente



Egon Gjadri

pajisur njeriu nga natyra, dhe kush e njeh sadopak historinë e vendit tonë e di mirë se shqiptarët gjysma e shekullit XX i gjeti në një gjendje tejet të prapambetur teknike. Nëse revolucioni i parë industrial shënoi shndërrimet e mëdha të diktuar nga përdorimi i qymyrit, revolucioni i dytë i përket futjes së përdorimit të energjisë elektrike, dhe i treti të asaj përthamore. Vendi ynë kaloi nga kovachanat mesjetare tek revolucioni i dytë industrial në harkun e dy dekadave. Kuptohet, ky progres nuk mund të lidhet as me ideologjinë e asaj kohe dhe as me direktivat politike. E ardhmja e një regjimi varet kryeqëndues nga progresi teknik i vendit, dhe nëse asokohe planifikoheshin hidrocentrale apo vepra të tjera, kjo bëhej pse politika e shihte realizimin e veprave të tilla si kusht të domosdoshëm për mbijetesën e vetë sistemit.

Ishte koha vetë që sillte me vete atë nivel progresi teknik, dhe në disa aspekte teknologjia e përdorur ishte në lartësinë e kohës, ndërsa në aspektin e ideve dhe të projektideve mund të themi pa drojë se talenti i inxhinierëve tanë do të gjente vlerësimin maksimal edhe në vendet më të përparura përdorimit.

Zhvillimi teknik është i njëanshëm, pra, nuk sjell vetvetiu zhvillimin e gjithë shoqërisë në të gjithë parametrat e saja, por ama krijon kushtet e nevojshme që shoqëria të zhvillohet mbi baza solide. Mund të themi se gjuha e teknikës është vetmja gjuhë që i shpëton arbitraritetit të ideologjisë, pasi relacioni mes teknikës dhe njeriut – përtej mballomave të propagandës dhe ideologjisë – nuk mund të ndërmjetësohet nga asgjë dhe ky është privilegji i gjuhës së numrave dhe formulave matematike.

Duke parë figurën e shkencëtarit Egon Gjadri dhe të kolegëve të tij, mund të themi se në kushtet e Shqipërisë së asaj kohe, niveli i lartë që arriti shkencën projektuese krijoi mekanizma të vetërritjes në kushte izolimi dhe automatizma që perfeksionuan një gjeneratë njerëzish të apasionuar që punuan me përkushtim për vendin e tyre. Në këtë kontekst një meritë e madhe i takon të paharrueshmit ing. Egon Gjadri, që u rrit dhe u formua por edhe rriti dhe formoi me punë dhe me eksperimente një përthamë kërkuesish dhe projektuesish pa të cilët Shqipëria nuk do të kishte arritur të transformohej nga pikëpamja teknike.



Egon Gjadri (i katërti nga e djathta), pjesëtar i ekipit të voleybollit të Tiranës.

të mirëfillta të shkencës shqiptare si: P. Radovicka, G. Struga, A. Bezhani, S. Kosturi, S. Peci, S. Kromiqi, F. Shehu e shumë të tjerë. Ing. Gjadrit u akordua titulli "Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor" nga Komisioni i Lartë i Atestimit dhe në vitin 1995, dhe në sajë të punës së tij projektuese dhe shkencore, u akordua titulli "Drejtuës Kërkimesh Shkencore". Të dy këto tituj janë tregues të vlerësimit unanimit që ai gëzonte në gjirin e bashkësisë së shkencëtarëve shqiptarë të asaj kohe.

Ing. Egon Gjadri ka marrë pjesë si projektues kryesor ose si bashkë-projektues në veprat më të rëndësishme që janë realizuar në Shqipëri. Ndër ta veçojmë: hidrocentralet e Shkopetit, Bistricës I dhe II, Vaut të Dejës, Komanit, Banjës, në Njënjë hidroelektrike të Buvilës, në 14 tunelet e linjës hekurudhore Elbasan-Përrenjas, në tunelin e Qafë Thanës, në tunelin e Koshovicës, në tunelin e Tarazit, ka bashkëpunuar në skemën e shfrytëzimit të lumit Drin dhe në skicëndën e hidrocentralit të Skavicës si dhe në projektëndën e hidrocentralit të Bushatit. Edhe tunelet e turbinave dhe tunelet e shkarkimit në Fierzë janë pjesë e kontributit të tij madhor.

Është thënë se teknika është vijimi artificial i mjeteve organike me të cilat është

A

ARGUMENT

NGA LUAN RAMA

Kontributi i shqiptarëve në betejën e madhe historike të Marignano-s së Italisë më 1515, midis trupave franceze të udhëhequra nga mbreti François I dhe atyre gjermane e zvicerane në krahun tjetër ishte vendimtar, pasi në castet kur pas dy ditë luftimesh, dukej se ushtria franceze po mundej, nga Venediku me shpejtësi gjatë gjithë natës erdhën stratotët shqiptarë të udhëhequr nga kondotieri Bartolomeo Aviano dhe kryestratioti i famshëm Merkur Buas Shpata. Pas kësaj fitore dhe kthimit të tij në Francë, katër vjet më vonë, mbreti francez i kërkoi mjeshtrit të tij Leonardo Da Vinçit, të cilin ai e kishte vendosur në Amboise, ti përgatiste një spektakël ndeshesh kalorasiak, e cila për nga madhështia, konsiderohet si ndër më të mëdhatë në historinë e shfaqjeve kalorasiake botërore. Kalorësit shqiptarë prej kohësh kishin krijuar në Francë atë që quhej «kalorësia e lehtë shqiptare» («La chevalerie legère albanoise»). Në gardën e tij, si dhe mbretërit e mëparshëm, François I kishte shqiptarë e tij, mes të cilëve një nga stratotët e lavdishëm Bokali, për të cilët, shumë kronistë tregojnë se pas një betejë të madhe me turqit në muret e Athinës, ata më së fundi ishin nisur me anijet veneciane drejt Venedikut, për ti shërbyer kështu Republikës Venedikase.

Lidhur me Bokalin ende nuk kemi shumë të dhëna rreth itinerarit të kësaj familje stratotie të emigruar në More nga Shqipëria. Më pas, me pushtimin e Moresë nga turqit, dhe luftimeve nën flamurin venecian kundër tyre, ata hynë në shërbim të Venedikut duke ikur në Itali. Nga arkivi i senatit të Venedikut ka një shkresë të 22 shtatorit të vitit 1480 edhe për familjen Bokali. Për të shkruhet se Senati ka vendosur «një pension për familjen e të ndjerit Dhimitër Bokali, i cili ka lënë në varfëri gran dhe një vajzë 7 vjeçare, i cili ishte një prej stratotëve të dërguar në Durrës bashkë me 300 stratotët të tjerë për të ndihmuar Kruijen. T'i jepen gruas 3 dukate në muaj dhe vajzës 150 dukate për priken e saj».

Sigurisht, meshkujt e familjes së tij ishin angazhuar nëpër luftat e Italisë, por ne nuk e dimë ende se cilët ishin ata. Në një burim historik rreth Merkur Buas, fletet se më 1527, në krah të Gjergj Buzikut, i cili ishte shpallur «Kalorës i Shën Markut», luftonte dhe Teodor Bokali. Dimë gjithashtu se gruaja e parë e Merkur Buas ishte Maria Bokali, bija e Nikollë Bokali dhe vajzë e Katerina Arianiti (e familjes së Skënderbeut), martesë kjo e vitit 1524, kur Merkur Buas ishte dyzet vjeçar dhe një kalorës me famë tashmë. Për arkondët Bokali të Greqisë, shkruan dhe historiani i njohur Jacob Philipp Fallmeyer.

SPEKTAKLI I MADH PËR MARIGNANO-N

Për organizimin e festës përkujtimore të fitores në betejën e Marignano-s, në pranverën e vitit 1518 Leonardo Da Vinci punoi bashkë me Bokalin dhe stratotët e tij, të cilët do të ishin pjesmarrës në këto ndeshje kalorasiake. Vetë Leonardo nuk na ka lënë shënime rreth këtij spektakli, por ambasadorë apo pjesmarrës të tjerë na kanë lënë disa përshkrime që tregojnë përmasat e këtij spektakli të organizuar me gjenialitet nga ana e Leonardos, siç e kishte zakon ai të organizonte shumë festa për mbretin duke përdorur fishekzjare, ballona, e elementë të tjerë inxhinjrikë.

Në fakt, ndeshjet kalorasiake kishin filluar që më 1 mars të vitit 1518. Sipas ditarit të historianit të shquar venecian, Marino Sanuto, i cili ka shkruar shumë për stratotët shqiptarë, ne njihemi sot dhe me disa letra që ai ka dërguar nga Amboise që më 1 mars 1518, ku përshkruan zonën afër kështjellës

Për organizimin e festës përkujtimore të fitores në betejën e Marignano-s, në pranverën e vitit 1518 Leonardo Da Vinci punoi bashkë me Bokalin dhe stratotët e tij, të cilët do të ishin pjesmarrës në këto ndeshje kalorasiake. Vetë Leonardo nuk na ka lënë shënime rreth këtij spektakli, por ambasadorë apo pjesmarrës të tjerë na kanë lënë disa përshkrime që tregojnë përmasat e këtij spektakli të organizuar me gjenialitet nga ana e Leonardos, siç e kishte zakon ai të organizonte shumë festa për mbretin duke përdorur fishekzjare, ballona, e elementë të tjerë inxhinjrikë.

Da Vinçi, mbreti François i I-rë dhe stratotët shqiptarë



Për Bokalin

Lidhur me Bokalin ende nuk kemi shumë të dhëna rreth itinerarit të kësaj familje stratotie të emigruar në More nga Shqipëria. Më pas, me pushtimin e Moresë nga turqit, dhe luftimeve nën flamurin venecian kundër tyre, ata hynë në shërbim të Venedikut duke ikur në Itali. Nga arkivi i senatit të Venedikut ka një shkresë të 22 shtatorit të vitit 1480 edhe për familjen Bokali. Për të shkruhet se Senati ka vendosur «një pension për familjen e të ndjerit Dhimitër Bokali, i cili ka lënë në varfëri gran dhe një vajzë 7 vjeçare, i cili ishte një prej stratotëve të dërguar në Durrës bashkë me 300 stratotët të tjerë për të ndihmuar Kruijen. T'i jepen gruas 3 dukate në muaj dhe vajzës 150 dukate për priken e saj».

mbretërore dhe se aty përballë kishte një lloj podiumi ku rrinte mbretëresha dhe ambasadorët («ku u gjenda dhe unë në vendin e ambasadorit të Ndriritur», shkruan ai). Ndër të tjera ai pohonte: «Sot, në një vend jashtë mureve të qytetit Amboise, në fund kishte një hark triumfi dhe një kollonë ku varehin armët. Nga ora 18.00 erdhën 12 luftëtarë me kuajt e veshur me satin ngjyrë vjollçe dhe disa rradhë veluri në ngjyrë ari, zbukuruar me kordonë si dhe shalle në kokë plot ngjyra. Ishin Monsinjor Sainte-Mesme, Brion, Montmorency, si dhe Bokali e Lorges, këta të dy që plagosën fisnikun që vrau Monsinjor De Sisse, siç dhe ju kam shkruar: Luftëtarët u shoqëruan drejt vendit të ndeshjes me trompeta dhe nderime mbretërore. Aty rregulluan dhe kuajt dhe pas pak erdhi Mbreti një i krishterë shumë i bindur i shoqëruar nga 30 fisnikë të



tjerë, të gjithë të veshur, si dhe kuajt me cohë të zezë dhe pendë satini të bardha thjesht për dekor, sepse s'kishin ndonjë vlerë. Por ato bënin shumë efekt. Mbreti e mbante shtizën e skrimit me dorë të xhveshur; ndërsa të tjerët mbanin hesh-ta. Ata u vendosën rreth fushës së mejdanit. Mbreti ishte i shoqëruar nga duka i Urbinit, Zoti Francesco de Gonzague, biri i markazit të Mantovës, biri i konteshës Cajazzo apo konti napoletan Campobasso. Dhe të gjithë filluan të ndesheshin. Kishte goditje interesante ku heshtat u thyen në mijra copa, edhe pse ishin të holla si ato të stratotëve, me një kurorë në majë. Papritmas në mes të ndeshjes, dikush që quhej Monte Afilan vraponte drejt dikujt dhe tjetri e uli aq shumë hesh-tën sa që ajo preku kokën e kalit dhe i goditi syrin. Kali menjëherë ra pa jetë. Monte Afilan e gjeti veten poshtë kalit dhe shumë njerëz nxituan drejt tij për ta nxjerrë që andej... Ndeshja vazhdoi 22 orë dhe nuk pati ndonjë gjë veç hesh-tës së mbretit që goditi ballin e kundërshtarit që po rendëte përballë tij e që ngjan se ai ra i vdekur...»

Spektaklet e Leonardo Da Vinçit

Padyshim spektaklet e Da Vinçit sot për ne janë të paimagjueshme. Ambasadori Galeazzo Visconti i pranishëm në një spektakël tjetër në oborrin e Clos Luce shkruante atëherë si «ai bëri natën brenda natës duke vendosur një çarçaf të madh për të krijuar një lloj kubeje qiellore duke kapur në të shenja zodiakë që lëviznin, apo «planete» qiellore ku të gjithë mbetën gojëhapur. Në fillim oborri u mbulua me çarçafin blu dhe me një ngjyrë ari. Ishte një mrekulli ta shikoje. Kishte 400 fenerë që bënin dritë, që dukej se e kishin larguar natën...»

Siç del nga kjo letër: Bokali është një personazh i dorës së parë, edhe pse nuk ka një titull si princ, kont, dukë, markëz, etj. Më 5 mars, po nga Amboise, ai vazhdon të shkruajë për ndeshjet që ishin zhvilluar një ditë më parë, por ku mbreti nuk doli në arenë për tu ndeshur por vetëm fisnikët, në rradhë të parë Charles de Bourbon, ai që kishte drejtuar betejën e Marignano-s, si dhe princi La Roche, Vendome, duka d'Albanie, duka i Lorraine-s, princi Francesco Gonzaga, etj. Mbreti qëndronte krah mbretëreshës Claude de France, duke admiruar ndeshjet. Më 4 mars, në ndeshje, siç informon ai, futet dhe princi Oranges, por edhe mbreti, që siç thekson ai, theu plot heshtja trimërisht. Ai shkruan gjithashtu për luftëtarë me mbishkrime sipër tyre «laudatus sum in his quae dicta sunt mihi», që u thurrin lavdi këtyre trimave. Më 5 mars, mbre-

ti François I nuk ka dalë në ndeshje, ndërkohë që në fushë është shfaqur mbreti i Navarre-s, duka i Lorraine-s apo duka i Urbinit, etj. Më 14 mars, shkruhet një tjetër letër, ku ndër të tjera pohohet: «Pardje u shkruaja se do të organizohej pushtimi i një «kështjelle» të bërë apostafat, e pajisur me dy torra të mëdha anash dhe dy porta në qendër, ku djalhtas ka një portë dalje ndihmëse. Sulmi nuk u bë, por ndërkohë trupat afroreshin. Në fillim përparuan duke rendur disa stratotë të veshur me coha të kuqe e me të bardhë e të zezë si dhe me kapele të vogla (stratote). Dolën nga kështjella dhe 25 të tjerë nga çdo bastion, të veshur me petka flakë të kuqe dhe me të bardha. Monsinjor Bokali ishte prijësi i atyre që ishin brenda, i cili ishte veshur me një petk me mëngë të gjera prej mëndafshi të trashë të qëndisur në fije ari dhe mbante çomagën në dorë. Ndërsa prijësi i atyre që ishin jashtë ishte monsinjor Sainte-Colombe. Për disa kohë u përleshën duke shtyrë herë njërin e herë tjetrin. Pastaj ata që ishin brenda dolën të gjithë jashtë duke bërë që kundërshtarët t'ia mbanhin e po kështu dhe ata të këmbësorisë. Por erdhi dhe një grup këmbësorësh të kështjellës për tu ndeshur me ata me heshtja. Monsinjor Lorges ishte prijësi i këmbësorëve dhe ai u përlesh me ata që ishin jashtë, duke bërë gjoja se i kapte robër, ku disa prej tyre gjoja bënin sikur vriteshin apo të tjerë ia dhanë me të katra. Jashtë në fushë kishte 37 këmbësorë nga të cilët zviceranë që kishin si prijës Fleuranges, birin e Robert de la Mark. Kishte gjithashtu 200 luftëtarë me armë që i printe vetë Madhëria e tij, Mbreti, me uniformë me pupla, ndërsa të tjerët me rrobat që kishin gjatë ndeshjeve. Disa këmbësorë u përleshën me ata që dolën nga kështjella, me heshtja në duar. Më pas ndeshja u bë tek muret e «kështjellës». Të tjerë, me kuaj e shpata kundër mbretit. Pastaj artilleria u afrua dhe

ata qëlluan mbi "kështjellë", muret e së cilës ranë. Të tjerë e goditën kështjellën nga anët edhe pse jo me plumba. Disa topa qëllonin fort. Ndërsa ata nga brenda qëllonin me mosketa e pushkë. Në ajër fluturonin ballonat-gjyle që kishe qef t'i shikoje. Stratiotët vazhduan të përlesheshin, të binin robër njëri pas tjetrit, aty ku heshtat thyeshin nga goditjet përreth. Artileria u afrua edhe më shumë për nga kështjella duke qëlluar atë. Ata brenda mbroheshin mirë. Kalorësit e kalorësisë së lehtë dilnin nga prapa kështjellës dhe suleshin mbi rrethuesit duke u përleshur me këmbësorët, e po kështu dhe me kalorësit e tjerë, duke bërë që t'ia mbanhin. Pastaj ata u kthyen përsëri në kështjellë. Më vonë u sulën artilerisë që ishte vendosur në një të një kodrinë, duke e shtyrë atë tutje. Më së fundi erdhi mbremja. Ndeshtet vazhduan deri më 15 mars...

Marino Sanudo (i Ri) ishte një personalitet i njohur venedikas, i cili rridhte nga një familje fisnikësh që kishin pallatin e tyre « Sanudo » në « Grande Canale » të Veneçias. I ati kishte qenë senator por dhe ai do të bëhej senator dhe shkrimtar njëkohësisht, kronist i betejave të ndryshme ku mori pjesë, një dëshmitar spikatës i kohës së tregi në librin e tij « Storia della guerra di Ferrara » apo « Spedizione di Carlo VIII », kohë kur mbreti francez Charles VIII zbriti në jug të Italisë të marrë kurorën e mbretërisë së Napolit dhe që kishte me vete shumë stradiotë shqiptarë. Por shënimet më të rëndësishme të tij janë « I d'ari » ku shkruan gjthashtu dhe për lavidinë e Mërkur Bua Shpatës. Kur ishte në Amboise për festën madhështore të organizuar nga Da Vinci, ai dërgon dhe një letër tjetër (më 17 mars 1518), ku shkruante: «... Në ditën e parë të këtij muaji filluan ndeshjet kalorësiake që vazhduan gjasthë ditë përshji dhe luftën me shpata mbi kuaj, gjatë të cilave mbreti kishte mbledhur 12 fisnikë të afërt të tij dhe 24 fisnikë të tjerë për t'i zëvendësuar. Midis të dy mbëdhjetëve ishin Shën Paul, Leshkur, Amirall, Megeres, Montmorency, Brion, Bokali (Bochal), Brogje, seneshali Armagan, Lorges, Saint-Mesme dhe sir Perot, të gjithë të veshur me satin të zi dhe zbukuruar me pupla e me shirita, shumë kurajozë si dhe njëzetekatër të tjerët, të veshur bukur e me një rrobe të zeze. Ata u ndeshën me të gjithë kalorësit që mbërritën pastaj. Mbreti ynë hyri i pari me të 24 fisnikët, u përlesh me ata të dy mbëdhjetët në të njëjtën ndeshje, të gjithë ashtu plot hirësi. Kështu bënë edhe princat e kapitenët e tjerë, njëri i veshur në velur, tjetri në akllaz apo në rrobë damaskine, që të gjithë të veshur bukur. Çdo grup kishte ngjyrat e veta dhe në çastin e betejës me skrim, mbreti me të 12 trimat e tij u zhveshën dhe veshën rrobat me satin dhe gëzof të larmë, çka ishte gjë e bukur t'i shikoje në në ndeshjen e tyre me kalë ashtu dhe në atë me shpata. Dikush ra përtokë dhe si zakonisht bënin gjoja, kush mirë e kush keq. Por njëri që u ndesh me kalë me heshtë ra dhe vdiq në vend. Duka i Urbin-it, që kur po kalonte nuk e pa dikë në tokë duke nxituar me heshtën e tij e shkeli dhe ra sipër tij, si ai edhe kali i tij, por asnjëri nga ata nuk u vra. Duka luftonte bukur si me kalë ashtu dhe me shpatë dhe po kështu bënë edhe disa italianë. Zoti Frederico i Mantovës ishte jo me fat në këtë ndeshje. Një ditë ai rrezikoi të vritej nga shkelmimet e kalit të habruar të një korrieri. Por ai u hodh bashkë me një nga kuajt e tij të bukur: Kali u hodh aq lartë sa theu shalën me rripat dhe u shemb, por në sajë të ndihmës së madhe që iu dha, ai nuk ra në tokë. Pastaj kalorësin e zunë ethet, por tani është mirë... Më 14 të këtij muaji erdhën dhe 150 ushtarë të armatosur dhe veshur mirë si dhe 500 këmbësorë të armatosur dhe 30 kalorës të tjerë të kalorësisë së lehtë që të gjithë të veshur shqiptarçe. Po kështu u shfaqën dhe 32 topa e mortaja. Mbreti me mirësi dhe gjithë urdhërat e nevojshme dhe bëri atë çka duhej më mirë për të rrethuar kështjellën dhe për të shembur muret e saj. Pastaj mbetej veçse urdhëri i sulmit. Diku tjetër, mbreti u dërgoi disa ndihma atyre të kështjellës, hyri fshesurazi në të rreth 50 fisnikë të armatosur e këmbësorë të ndarë në zvicëranë dhe shqiptarë...»

Duke vazhduar tregimin e tij.....
«... Pastaj Monsignor Laason me shumë fisnikë e këmbësorë, të armatosur mirë që të gjithë, nisën sulmin. Mbreti doli dhe pati një ndeshje të bukur me armë, duke luftuar në këmbë me këmbësorët e tij, ndërsa kuajt kundër kuajve. Por midis këmbësorëve dhe kuajve kishte një barrierë, çka u bë diçka aq bukur, sa francezët thanë se kurrë nuk e kishin parë një pamje të tillë. Kur u zhvillua skena

e luftës, u qëllua me të gjitha topat e artilerisë, rreth 200 të shtëna, pa numëruar të shtënat me pushkë, duke shtuar këtu edhe trompetat, çka ishte një atmosferë e mrekulueshme e plot hire. Besoj se deri më sot nuk ka ndodhur të arrihet diçka kaq triumfale në Francë. Por mbreti pastaj nuk i la të sulmonin kështjellën, duke dështuar se dikush nga ata mund të vritej vërtetë, çka siguri ishte do të kishte ndodhur: Thonë se sot mbreti do të shkojë në Tours dhe pastaj në Bretagne...»

Në arkivat italiane janë letrat e përfaqësuesve të ndryshëm italianë, siç janë dhe ato të ambasadorit tjetër të Mantovës, Stazio Gadio, i cili i shkruan dukës së tij në Mantova për zhvillimet festive të datave 14 dhe 15 maj të vitit 1518. Ja çfarë shkruan ndër të tjera ai: «... Imagjinoi një shesh të madh dhe një "fortesë" të lartë sa një njeri mbi kalë, me krena dhe mure të veshura me coha me ngjyra që të duken si bedena kështjelle. Midis dy torrave ishte një lloj sheshi në lartësinë e një njeriu, e mbuluar me dërrasa. Përpara ishte një hendek i gjerë pesë krahë larg taracës. Mbi hendek ngrihet thikë një murajë me torra njëra pas tjetrës përgatitur me një cohë të ngjyer me bojë dhe të kapura me trarë, por që mund ta shkatërroje lehtësisht. Edhe torrart ishin të mbuluara me cohë të ngjyer dhe kishin flamur që valëviteshin në ajër, të zeza në mes, por dhe të verdha e të bardha. Mbi krenat dhe daljet mbrojtëse ishin vendosur shumë pushkatarë. Mbi taracë kishte topçinj me topa druri të rrethuar me hekur të cilat qëllonin me barut dhe nxirrnin flakë duke bërë zhurmë të madhe. Ballona të fryrë që binin nga lart mbi shesh, bënin që të shëmbeshin muret mbrojtëse pa dëmtuar njeri, çka krijonte një kënaqësi të veçantë. Ky spektakël i ri ishte krijuar me një talent shumë të madh. Në shesh kishte gjithashtu topa, por që hidhnin lecka e letra që të mos plagosnin njeri. Në çdo anë të sheshit, pranë "kështjellës", mbi mure ku gjendeshin 25 pushkatarë për çdo ndarje për mbrojtjen e "kështjellës" ishin 12 luftëtarë të armatosur e të veshur me takëmet e kalit, me kuajt dhe heshtat, duke patur armë veluri të verdhë dhe të mbështetur nga 30 kalorës të kalorësisë së lehtë, të veshur me të bardha si stradiotat, që kishin si prijes një të quajtur Bokali, shqyrtar i mbretit, me një kaskë pëlthure të praruar si dhe 100 këmbësorë të armatosur mirë me heshta dhe eskopeta (lloj pushke të kavalerisë franceze), nën urdhërat e kapitenit Lorges, që mbante flamurin bardhë e zi. Nga ana tjetër e sheshit, gjendej mbreti i madhërishtë me armët e tij të luftës, i veshur mrekullisht, i rrethuar nga oficerët e tij që kalëronin me heshtat mbi kofshë. Në krahun e majtë gjendeshin zvicëranët dhe shqiptarët e gardës me halebarda (sopata) dhe heshta si dhe me disa eskopeta...»

Padyshim spektaklet e Da Vincit sot për ne janë të paimagjinueshme. Ambasadori Galeazzo Visconti i pranishëm në një spektakël tjetër në oborrin e Clos Luce shkruante atëherë si "ai bëri natën brennda natës duke vendosur një çarçaf të madh për të krijuar një lloj kubeje qiellore duke kapur në të shenja zodiakë që lëviznin, apo "planete" qiellore ku të gjithë mbetën gojëhapur. Në fillim oborri u mbulua me çarçafin blu dhe me yje në ngjyrë ari. Ishte një mrekulli ta shikoje. Kishte 400 fenerë që bënin dritë, që dukej se e kishin larguar natën...»

Festat e përkujtimit të betejës së Marignano-s ishin të fundit për Leonardo-n. Atë kohë ai ishte 64 vjeçar por ngjante shumë plak, nga lodhja e madhe. Kishte një mjekër të gjatë siç e shohim në autoportretin që ka skicuuar dhe që mendohet se është e vitit 1515, vit i luftës së Marignano-s. Mbreti 27 vjeçar François I e çmonte shumë. Një vit më vonë nga ky spektakël historik ai do të vdiste atje, në Clos Luce, dhe mbreti që nxitonte nga Saint-Germain-en-Lay ta shikonte në castet e fundit ku siç thuhet e gjeti duke vdekur në shtratin e tij. Atëherë ai e mori trupin e tij në krahë me një dhëmbshuri të madhe... Vallë a ishte dhe Bokali aty?...»

Shënime

1-(Archivio Gonzaga, Esteri (Francia), XV, 3,634, tekst i cituar nga Edmondo Solmi në "Documenti inediti sulla dimora di Leonardo da Vinci in Francia nel 1957 et 1518, in Scritti Vinciani. Le fonti dei Manoscritti di Leonardo da Vinci e altri studi. La nuova Italia, editrice, Firenze, 1976, p.621-623.)

R

RRËFIM

Një përsiatje që mund të zgjidhjet edhe si etyd...

NJË QEN HERO

NGA NDUE DEDAJ

...Doemos, ndonjë qen kufiri, do thotë lexuesi pa e vrarë mendjen. E si mund të jetë një qen tjetër, hero? Apo dhe ndonjë qen i antidrogës, që duke nuhatur do të këtë zbuluar ndonjë magazinë mbushur deng me hashash? Por durim, i dashur lexues! Me qentë mund të jenë rrefyer histori nga më të fismet, sa me to do të mbeshej ndonjë antologji tri mijë faqe, kurse ndodhja që do t'u themi më poshtë, apo dhe mosndodhja, që dhe neve na e thanë, është në kufijtë e të pabesueshmes.

Pikërisht për këtë po ua rrefejmë dhe juve...

Kur gjahtari pa qenin e tij me buzët gjithë gjak, duke i lëpirë aty të porta e shtëpisë, si të kërkonte prej të zot ndonjë shpërbim për lodhjen në guetinë e para një gjysmë ore, iu turbullua truri, mendoi se qeni i tij besnik kishte qenë çmendur dhe i kishte mbytur të birin që flinte në djep, ndryshe si do t'i kishte turinjtë ashtu të përgjakur?!... Hoqi çiften nga krahu dhe shtiu tri herë mbi krijesën e giorë, që me siguri e kishte menduar si një shaka të të zotit çastin fatal kur i qe drejtuar arma dhe si lojën e vdekjes së tij të pamëshirshme.

Ai nuk ishte qen gjuetie, ndaj sa herë i zoti e fronte për këtë punë, bënte të pamundurën të kthehej në zagar, të nuhaste pas çdo shkurreje e gëmushe erën e lepurit, dhelprës, ujku, vetëm e vetëm që t'i bënte qejfin zotërisë, i cili dhe ai nuk ishte gjahtar, por, meqë e kishte shtëpinë buzë pyllit me lisa e pisha, i shkrepëj ndonjëherë e dilte për gjah.

Kështu ndodhi dhe atë ditë. Burri i tha të shoqes se do të vente për gjah, por ta kishte kujdes të voglin që flinte në djep si qingj i butë. Rri pa merak, ia ktheu ajo, fundja unë kujdesem çdo ditë për të, edhe kur ti je këtu. Por gruan e thirrën të Posta, ku punonte si centraliste, ngaqë shoqes së saj të turnit i kishte rënë të fiktë dhe e kishin çuar në urgjencë. Atëherë ajo i kishte bëzajt komshies që kishte dera - derës t'i kujdesaj për djalin, e cila herë pas here shtynte derën e shtëpisë së tjetrës dhe, kur shihte se djali po flinte pa e prishur terezinë, iu kthehej punëve të shtëpisë së saj.

Burri nuk dinte asgjë nga këto dhe fundja pse t'i dinte, ai kishte dalë për qejfin e tij të vriste ndonjë lepur, por nuk kishte vrarë gjë atë paradreke. Qeni sakaq kishte shkuar në shtëpi, kurse ai ishte vonuar dhe nga një gjysmë ore te një shoq i tij, që po piqte raki rrushi nën një strehë, por nuk kishte qenë në qejf për të pirë, thjeshtë kishte kthyer një gotë, sa për të bërë zakonin, duke e uruar shoqin: "T'u piftë për të shëndoshë!"

...Kthehemi tani aty ku zu fill ndodhja. Kur gjuetari po ulej nga cuprrelja sipër shtëpisë në oborr, sytë i zunë të shoqen që po kthehej nga qyteti i vogël buzë lumit. U befusua pak, por nuk pati kohë të mendonte se si e gysa ajo e kishte lënë të voglin vetëm brenda e kishte vajtur në qytet, pasi atë cast, siç dëftuam më sipër, i doli para qeni i tij me buzët e lyera me gjak!... "O Zot! Ky nuk ka gjetur fërluk sot në mal

dhe ka shqyer djalin tim në gjumë!" I vërshoi gjaku në kokë, qafë e fytyrë, ndjeu një rëndim të përgjithshëm, që ia errësoi shikimin, si ai rrebeshi që shpërthente papritur duke shkundur tokë e qiell. Shtiu tri herë mbi qenin e tij, që kishte dalë ta priste lumturisht...

Teksa qeni i ngratë po jepte shpirt të këmbët e tij me sytë ende të pafukur, burri hyri vrullshëm në shtëpi..... Por, ç'të shihte? Kishte ndodhur mrekullia! Një ujë i vogël ishte mbytur në një pellg gjaku, pranë djepit ku flinte vogëlushi, që atë cast u shtrigë duke hapur sytë e qeshur, si të kishte dalë nga një ëndërr e trëndafilte...

Kaq ishte fabula e këtij tregimthi, ama ia vlen të zgjatemi dhe ca, jo për t'u shpjeguar juve atë që e merrni vetë me mend... që burri në çastin kur pa ujkun e vrarë e kuptoi pse qeni i tij i kishte pasur turinjtë e përgjakur deri të veshët, ngaqë ishte përleshur përjetë a vdekje me ujkun, gjersa e kishte mbytur. Qeni e kishte bërë gjëmën pa u menduar



dy herë, nëse ujku vogëlith nuk kishte pasur asnjë qëllim të keq ndaj atij fëmijë, përkundrazi kishte shkuar deri aty për të zënë shoqëri të të voglin dhe po e priste atë që të zgjohej. (Fundja diçka e tillë duhej të kishte ndodhur në epep tona, përdërisa kishte njerëz me emrin Ukë, Ujkan etj.) Qeni ynë hero nuk kishte pasur kohë t'i mendonte të gjitha këto, por duke besuar se i forti i pyllit kishte hyrë në dhomë për të vrarë fëmijën, i kishte kërcyer në qafë dhe e kishte larë në gjak ujkun fëmënor...

Eh, qeni vrasës, po ta dinte si kishte qenë e vërteta, do të ishte shkrehur në lot për atë që kishte bërë e do të kishte vrikuar të mbyteje të Hurdha me Trunji, aty ku zakonisht i mbsynin këlyshët e vegjël të sapopjellë nga bushtrat, përpos njëra e dy që iu duheshin për stelin në oborr e gjënë e gjallë. Kishte qenë bash e lehura e tij e çirruar, kur ai po gjuante në mal dy orë më parë, që i kishte kallur frikën në palcë ujkut të vogël në stroullin, sa ai t'ia mbasthte nga sytë - këmbët, duke u futur pa e ditur se ku, drejt e në shtëpinë e atij vetë... qeni vrasës!

Por nuk kishte pasur kohë të kthjellohej qeni para ujku.

Nuk kishte pasur kohë të kthjellohej as njeriu para qenit.

Dhe kishte ndodhur hataja dy here... flakë për flakë... njëra pas tjetrës... bambam. Një zot e di se si ishim këto punë. Fundja ky kishte qenë fati i heronjve. Kurrë nuk ishin mirëkuptuar për atë që kishin bërë, përdërisa dikush do t'i merrte për të atë, domethënë heronj, e dikush tjetër për kriminelë!...

LIBER

NGA DR. IRENA GJONI

1. Hyrje

Libri *69 Gra* i Arbër Ahmetajt, mund të konsiderohet si një dhuratë e çmuar e autorit jo vetëm për lexuesit besnikë të tij me rastin e 25 vjetorit të botimit nga libri i parë në vitin 1993, por edhe për çdo lexues të kultivuar e potencial që e adhuron mjeshhtërinë e rrëfimeve të shkurtra dhe që lehtësisht e gjen te ky libër. Është një botim i shtëpisë botuese prestigjioze Skanderbeg Books që në vite ka sjellë edhe librat e tjerë të Arbër Ahmetajt e ka rezultuar si një bashkëpunim shumë i suksesshëm. Në këtë vëllim janë përmbledhur 13 proza, që sipas autorit, vijën si një *Gërmadhë letrare: As tregime, as novela, aq më pak romane*. Ky përcaktim, më rikthen në retrospektivë, pikërisht te fillesat letrare të Ahmetajt.

2. Shenjimi i rrugëtimit letrar

Fryma imponuese e letërsisë cilësore dhe ndikimi i saj, shpesh herë krijojnë një marrëdhënie sa magjike, aq edhe të çuditshme me shpirtin njerëzor. Më tepër sesa e pashpjegueshme në dukje, vihen në lojë "receptorë" të nënndërgjegjes, sesa vetëm prej tyre mund të perceptohet gjithçka që është gati brenda unit të autorit nën efektet e muzës dhe jo vetëm, që të bëjnë ta njohësh, ta duash e ta vlerësoh atë veprë. Është pikërisht ky libër, ky impakt e kjo lidhje, që të jep besueshmërinë dhe garancinë e mëpastajme për të marrë në duar pa frikë veprat e radhës së të njëjtit autor dhe të ndiesh se prej tij e ke të garantuar kënaqësinë estetike.

Dhe pikërisht, kështu ka qenë takimi im i parë me autorin Arbër Ahmetajt dhe me librin e tij *Fletëhyrje për në varr* në vitin e largët 1994 (një vit pas botimit). Ishte koha kur një brez studentësh dhe dashamirës të letrave, të etur për një letërsi cilësore dhe jashtë kompozicionit të letërsisë së mëparshme, ditëm ta mirëprisnim këtë autor dhe veprën e tij, fragmente të cilët ishin prezantuar si risi në shtypin e kohës. Perceptimi i parë ishte i një libri "ndryshe", ku në vend të përcaktimit të llojit të prozës, vinte si nëntitull: *Shënime për s' di se çfarë drejt veprë letrare*. Jo vetëm për strukturimin e pazakontë, por edhe për idetë e pasura brenda lakonizmit, për fatet tragjike të personazheve, për rrugëtimitin rrënoqthës në ferrin shqiptar të dhënë përmes ferrit letrar të krijuar nga Ahmetaj, ku çdokush gjente sadoqap nga shpirti i vet, Fletëhyrja për në varr u bë "fletëhyrja" e sigurt për një shteg të ri letrar të përfaqësuar nga Arbër Ahmetaj, ku gjurma e tij është origjinale, unike dhe e pangatërrueshme.

Kjo besueshmëri e garanci për të përcjellë vlerë, që u dha qysh me veprën e parë, do vijonte në gjithë rrugëtimitin letrar të Arbër Ahmetajt, për të mbërritur deri te libri i fundit *69 Gra*, që pata fatin ta lexoj në dorëshkrim.

3. *69 Gra* si mjeshhtëri narracioni

Te libri *69 Gra*, nënvizohen karakteristikat dhe veçori të prozës, që e veçonin Arbër Ahmetajn nga prozatorët e tjerë. Talenti i tij i lindur, përvoja e akumuluar, perceptimi i realiteteve (në mënyrë të vullnetshme, apo të pavullnetshme), aftësia e trillimit, mpleksionit së bashku duke u përthyer në prizmin e tij artistik për t'u shfaqur përtej këtij prizmi me pamjen fisnike e sharmante të prozave të mrekullueshme që na ofrohen te ky libër.

Pra kur lexuesi ta marrë në dorë këtë veprë, do vërejt se ajo çka lexon përmes gjuhës nuk është vetëm materializimi i mendimit, por edhe pafundësi e shpirtit njerëzor. Kjo është udha e krijimit të kjo veprë, apo e zbulimit të vetvetes, e krijimit e rikrijimit të universave të ndryshme (njerëzore a letrare), përmes narracionit plot ritëm të Arbër Ahmetajt.

Vitet re që secila prozë e librit *69 Gra*,

Autorja bën një përshkrim letrar të veprës së fundit të autorit dhe po ashtu edhe për elemente të tjera të krijimtarisë së tij...

69 gra i Arbër Ahmetajt si mjeshhtëri narracioni


vjen unike edhe sipas dominantit tematik, edhe sipas dominantit strukturor me struktura kompozicionale të ndryshme, çka shenjohejt si një nga vlerat e këtij vëllimi. Kjo larmshmëri në çdo aspekt, bën që këto proza të lexohen me një frymë, pa u kthyer në monotone e duke ruajtur magjinë e befasisë dhe dëshirën e zbulimit.

Aftësia e Arbër Ahmetajt është që përmes rrëfimit të tij, përmes teknikës së ndryshimit të strukturës së hapësirës dhe kohës, brenda 13 prozave të tij, të na çojë njohëresh sa me mungesë gravitacioni mbi qiejt e mjegulluar mes Francës, Britanisë dhe Irlandës, aq i sigurt në tokë në kushedi sa destinacione; sa në pyllin e fëmijërisë e shtëpinë buzë rrugës që çonte për në zonën e thellë të Lekëbajve, në metropolet e botës; sa në Dublinin e Xhojsit, në Ballkanin tragjik; sa në kohën e Ciklit të Kreshnikëve, aq në modernitetin e kohës së tij; sa në ndjesitë e para erotike të një adoleshenti, në përvojat e një burri dhe ndikimit të grave në jetën e tij; sa në lirinë e ndrydhur brenda një kryqi të fshehur në gjë në një regjim të frikshëm, në hapësirat pa limit të mendimit të një qytetari të botës.

Funksioni estetik është mbizotëruar te ky libër, por po kaq na shfaqet edhe funksioni njohës dhe kjo si një filozofi e autorit në zgjerimin e përmbajtjes së vizioneve për botën, por edhe si nevojë për zhvillimin e sistemeve të komunikimit, në këtë rast të komunikimit letrar. Autori sjell copëza bisedash për letërsinë, poetët, udhëtarët, siç ndodh te proza *Dublinasit*. Si në një palimpsest vijmë vizionet e fëmijërisë, ku fati i tyre është përcaktuar e shenjuar nga rrethanat e kohës si te proza *Gëzuar Krishtlindjet*. Bisedat spontane me nënën dhe kapërcimet e natyrshme tematike sa të veshura me një tisiqeriteti fëmijëror dhe një urtie filozofike, duke u bërë pjesë të botëve të njëri - tjetrit, bartin atë lidhje të pakusht dhe të patjetërsueshme nën - bir te proza *Hëna kjo putanë kozmike*. Notat e humorit duke ruajtur senset e masës, vijmë jo vetëm si një mjet për të sthensionuar situatat dramatike përgjatë narracionit, por edhe si një mënyrë këndvështrimit mbi to, si te proza *Fqinja Jona përveçluese, A mund të dashuroh kurr vend udhëheqësi etj.*

4. Dimensio shpirtëror e psikologjik në botëperceptimin e realitetit

Cdo prozë, është një botëperceptim i realitetit si dhe ekzistencës shpirtërore, shpesh herë të kushtëzuar nga ky botëperceptim realiteti. Pra, situatat e gjendjet, vijmë prej realiteteve jetësore, ku gërshetimi i përthyerjeve të gjendjeve shpirtërore, mvishen nga Arbër Ahmetaj me një mantel gjuhësor për t'u pasur lakmi. Strukturat narrative janë të pasura me përshkrime situatash, personazhesh, ndjesi, botë shpirtërore, ashtu si dhe me komente. Në këtë kontekst, autori sjell burrin që kthehej në atdhe me të birin e vdekur, doktor Symeonidhis me rrëfimin e brengën e tij, Palamasin me madhështinë e përshkrimit të dhimbjes njerëzore, Hallin e Ciklit të Kreshnikëve të cilët të gjitha gratë i dukeshin si motra, udhëtarët e huaj në oborin e tepelenasit të Janiës, therjen e hakmarrjen e pyllit, vajzën e vogël pa veshka të baladës, Poeten në dhomat e hotelit të Gjuetisë së Kontit Çiano, gratë e revoltuara me të cilat nuk do të punojë më, kamarierin e Madigan's Pub me tatuazhin e Oskar'i ndër shalë, N.Gj. dhe historinë e burrit që ishte nisur për të kthyer nnderin në vend, burrit të cilët diabeti ia kishte thyer tehen e sopatës, thyerjet e thella të dritës e të brigrive mbi oqean, Xhejmsi Xhojsin dhe Betejën e Pash-



këve tek Posta e Dublinit, gruan iliro-irlandeze që këndonte me harpë, Zhaklinën D. macet e botës së tretë, fqinjën përveçluese, marrëdhëniet vëllazërore, imazhet e trishtatë jetës studentore, fatet e dashurive dhe jetëve njerëzore nën një regjim diktatorial etj. Te të gjitha bie në sy dimensionit i analizës psikologjike, veprimi i brendshëm i personazhit duke u perceptuar nga narratori, i cili në pjesën më të madhe rrefën në vetën e parë (me përjashtim vetëm në tri proza, nga një narratori i jashtëm). Gjithashtu, përshkrimi i ambienteve në këto struktura narrative, është i rëndësishëm dhe bëhet funksional duke shërbyer për të çuar më tej motivimin psikologjik të personazheve.

Njohja e vlerave etnopsikologjike të personazheve (shqiptarë, apo me etni të ndryshme), është shumë e dukshme te ky libër. Njëherësh jepen edhe të dhëna antropologjike që ndihmojnë në ndërtimin e lëndës tregimtare, apo në gjendjet e karakterizimit e personazheve, apo në situatat në të cilat ata vendosen brenda konteksteve të caktuara.

69 gratë që i dhanë titullin librit

Cdo prozë e këtij libri vjen me veçantinë dhe shkëlqimin e saj. Por si një sintezë e një pjesë të rëndësishme të jetës së narratori të këtij libri, vjen edhe proza që i ka dhënë titullin librit, *69 Gra*. Duke i qëndruar besnikë mungesës së klasifikimit të llojeve nga ana e autorit që në hyrje të tij, te kjo prozë është akoma më e vështirë të përcaktohet, nga mënyra se si e ka sjellë Arbër Ahmetaj imazhin e 69 grave. Mund t'i konsideroja si 69 bërtama narrative, të 69 tregimeve. Mund t'i konsideroja si 69 proza poetike me gjetje e detaje artistike shpeshherë të realizuara me një fjalor të përzgjedhur poetik. Mund t'i konsideroja si 69 personazhe gra të skicuara që me një rresht, deri në një paragraf, por jo me shumë. Ravijezime portretesh të bëra në mënyrë shumë lakonike e të thukët, por meritë e Arbër Ahmetajt është që edhe pse me kaq pak, mundet të japë individualitetin e origjinalitetin e pangatërrueshëm të secilës prej këtyre grave, si në imazh, si në historinë e intriçigj që e identifikon.

Janë ravijezime të bëra me shumë dashu-

ri, pavarësisht nga rrethanat e "njohjes" me to. Ato lëvizin si nga hapësirat reale, hapësirat e legjendave, të historisë, të mitit, të fantazisë, të kombësive, rracave e moshave të ndryshme. Erosi është këndvështrimi që herë bëhet i dukshëm, i drejtpërdrejtë dhe herë i fshehur apo i kamufluar nën drita të tjera, por që nëpërmjet tij bëhet edhe vlerësimi në kompleksitet i qenies femërore me gjithë vrytitet e anët e errëta dhe karakteristikat individuale që bart secila. Vërehet diskursi vlerësues dhe admirues për të parë e shijuar "të bukurën" edhe përmes errësirës.

Kjo renditje fillon me Anna 0, ku Ahmetaj shkruan: *Të mora nga një aromë pragpranvere e të bëra grua, personazh në romanin tim. Tashmë ti ke mbetur e kurthuar mes faqeve të letrës dhe gishtave të lexuesve. Më fal, Anna! Se vetes nuk mund t'ia fal!* Më pas vijmë gratë e tjera me individualitetin përkatës deri te numri 69 që nuk ka më një emër konkret si 68 të mëparshmet, por vjen si një përgjithësim: *Të tjerat, ku Ahmetaj përfundon: Gratë e tjera të jetës time s'dëshën të hyjnë në libër, por mbeten rebelë, ashtu si ditën kur më thanë: JO! Ato nuk më dëshën. Më kundërshtuan. Unë i kam dashur atëherë, i dua edhe sot.* Në këtë renditje të 69 grave të Arbrit, duket sikur nuk ka ngelë model femëror pa u përfshirë dhe jo pa qëllim kjo prozë i dha edhe titullin librit.

Shoqërimi i ndonjë proze të librit me shënimin: *Ngarja e tregimit është reale me përjashtime të vogla*, toponimet reale, inicalet e personazheve po realë, emra konkretë të personaliteteve të njohura nga fusha të ndryshme, kryesisht e letrave, vihen në funksion të dëshmisë së vërtetësisë së rrëfimit dhe besueshmërisë së këtij realiteti artistik, si për të krijuar një lidhje akoma më të ngushtë mes autorit e lexuesit. Në këtë linjë vjen edhe dedikimi i autorit në këtë libër si një mirënjohje: *U kushtohet: Miqve të mi zvicëranë që prej 21 vjetësh më janë gjendur me çiltësinë dhe miqësinë e tyre të çmuar; duke rënditur shumë emra të miqve të tij që njohëresh janë edhe lexues të letërsisë së tij që për vlerat që posedon, prej vitesh i ka kapërcyer kufijtë me përthimtet në shumë gjuhë të huaja.*

Pra si përfundim, pas leximit të librit *69 Gra* të Arbër Ahmetajt, më gëzon fakti që ky libër nuk mbyllet me përfundimin e leximit të faqes së fundit, por të mban ende të mbërthyer pas vetes me përthimtet mbi të. Me rrëfimin e përkorë e plot ritëm, me konceptimin modern të bërtanave narrative që në gjenëzë, me një shumësi strukturash kompozicionale, me mjeshhtërinë e kapërcimeve shumë të natyrshme nga njëra situatë në tjetër në vende e kohë të ndryshme, me galerinë e pasur të personazheve ku çdonjëra përvojë e përjetim nuk i ngjan tjetrit, me notat e humorit që të dhurojnë një ndjesi të këndshme buzagatë edhe në mes të tensionit dramatik, me fillin e dashurisë polise-mantike që përshkon çdo lind të prozave, me ide të ngjeshura e me një larmi strukturash gjuhësore, stilesht etj., me këtë libër konfirmohet edhe një herë se Arbër Ahmetaj është një nga emrat më të rëndësishëm të letrave shqipe duke e çuar në një stad më tej prozën e shkurtër shqipe. Libri *69 Gra*, nuk zhgënj pritisshmëritë e lexuesit i mësuar me një standart shumë të lartë që sjell proza e Arbër Ahmetajt, ndaj pa frikë mund tua sygjeroja të gjithë lexuesve që dinë ta shijojnë një letërsi cilësore, të cilët tashmë e konsiderojnë si një festë e ngjarje letrare ardhjen e çdo librit të ri të Arbër Ahmetajt.

Opinion *i* Ditës

Vetingu i Lu, njerëzit e Soros në gjykata

Nga Todd Wood

(vijon nga faqja 1)

... axhendë antikorruption për të cilën shumë kritikë thonë se u shndërrua në sulm kundër partive dhe politikanëve konservativë shqiptarë, duke përkrahur fort të ashtuquajturën "reformë në drejtësi".

Ai punoi me qeverinë socialiste të kryeministrit Edi Rama, një qeveri e përkrahur fuqishëm nga miliarderi filantrop e investues amerikan George Soros. Rezultati i fushatës: një kolaps i plotë i qeverisjes kushtetuese në vendin ballkanik. Reformat që përkrahu zoti Lu kanë çuar në një "proces vetingu" për të garantuar vendosjen e gjyqtarëve të pakorrupuar në gjykata. Në teori tingëllon bukur, por pasojat kanë qenë krejt ndryshe në botën reale. Aktualisht në Shqipëri nuk ka Gjykatë Kushtetuese aktive për shkak të mungesës së kuorumit dhe nuk pritet që gjykata të funksionojë në të ardhmen e afërt.

E gjithë kjo ishte pjesë e një plani, sigurisht - instalimi i njerëzve pro-Soros në pushtet dhe pastaj bërjen të pamundur për opozitën që t'i sfidojnë në gjyq. Ngjason frikshëm me ato korret "Anuloni ICE" dhe "Numëroni të gjitha votat, edhe ato të paligjshme" që votuesit amerikanë dëgjuan në zgjedhjet e fundit ndërsezonale. Me opozitën dhe gjykatat të neutralizuara, politikanët shqiptarë kanë lejuar me shumë kënaqësi oligarkët të bëjnë pasuri falë kontratave me qeverinë. Me një qeveri pro-Soros në fuqi vijon edhe projektet e parapëlqyera nga Soros, përfshirë legalizimin e drogës, promovimi agresiv i të drejtave të homoseksualëve dhe kufijtë e hapur.

Shqipëria ishte thjesht një fushë testimi për axhendën e Sorosit. Tani pjesa tjetër e Ballkanit dhe Azia Qendrore mund të shijojnë së shpejti kënaqësinë e llojit të veçantë sorosian të globalizmit të detyruar liberal. Alex Soros, djali i perandorit, ka udhëtuar nga njëri kryeqytet ballkanik në tjetrin, duke takuar krerë shtetesh për të përhapur lajmin e mirë e për të promovuar vetitë e politikave liberale të imigracionit.

Në Kosovë, një "shkëmbim teritorësh" i përkrahur nga Soros mund të çojë në dhunë serioze etnike midis shqiptarëve dhe komuniteteve serbe (edhe Kancelarja gjermane Angela Merkel është kundër idesë). Gjëja e trishtueshme është që administrata Trump, e trazuar nga ngjarjet e brendshme dhe krizat ndërkombëtare, duket se përmes neglizhencës së saj ja ka deleguar diplomacinë dhe politikën ballkanike dyshes babë e bir Soros. Tani vjen lajmi alarmues që zoti Lu, pasi



promovoi axhendën e Sorosit në Tiranë, është konfirmuar nga Senati dhe instaluar si ambasadori amerikan në Kirgizstan. Është sërish e sikletshme që administrata Trump duket e pavetëdijshme për pasojat e zgjedhjeve të veta diplomatike.

Përfituese është axhenda e Sorosit për rajonin, e cila ka si objektive vende të pastabilizuara që ende përpigjen të krijojnë qeverisje të qëndrueshme. Është e mirëdokumentuar se si Departamenti i Sh-

teti në Shqipëri e ka kundërshtuar hapur axhendën e Presidentit Trump "Amerika e para", deri në atë pikë sa ka shpallur "rezistencën" dhe punon me qeverinë e Ramës për axhendën shumë të dyshimtë të "reformës në drejtësi". Shqipëria nuk është tamam një prioritet i politikës së jashtme dhe zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë me kanë thënë në konfidencë se këto çështje kalojnë pa iu kushtuar shumë vëmendje për shkak të instabilitetit dhe zjarreve më të mëd-

henj me të cilët duhen të merren çdo ditë.

Por vendimet e personelit duhet të kenë vëmendje të veçantë, teksa njerëzit e erës Obama në But personal decisions should be a particular area of concern, as Obama-era holdovers at DSH punojnë në heshtje për të shkatërruar axhendën MAGA (Ta bëjmë Amerikën përsëri të madhe). Sekretari i Shtetit Mike Pompeo "po kalon kohë të vështira. Departamenti i Shtetit është një kënetë e madhe", më thanë. Mos më besoni mua për pasojat politike të lënies së diplomatëve si Donald Lu në detyrë, thjesht shihni sitin e Open Society të zotit Soros. Zoti Lu lëvdohet si një "ambasador i ri që ofron shansin për ta nisur nga e para".

Jam i bindur që kryeministri Rama lloboi fort që Lu të merrte postin në Kirgizstan. Amerika duhet të vendosë rregull në trupin e saj diplomatik. Zyrtarët e Shërbimit të Jashtëm i shërbejnë Presidentit të Shteteve të Bashkuara, jo përparësive të tyre. Është koha që ta kuptojnë këtë. Nëse jo, duhet të kenë mirësinë të japin dorëheqjen.

Washington Times

Shqipëria ishte thjesht një fushë testimi për axhendën e Sorosit. Tani pjesa tjetër e Ballkanit dhe Azia Qendrore mund të shijojnë së shpejti kënaqësinë e llojit të veçantë sorosian të globalizmit të detyruar liberal. Alex Soros, djali i perandorit, ka udhëtuar nga njëri kryeqytet ballkanik në tjetrin, duke takuar krerë shtetesh për të përhapur lajmin e mirë e për të promovuar vetitë e politikave liberale të imigracionit.

HOROSKOPI

DASHI

Mos shpresoni tek fati dhe përqendrohuni tek shëndeti. Ka ardhur koha të kontrolloni peshën trupore dhe të nisni ushtrimet fizike. Shpenzoheni kohën e lirë me fëmijët tuaj. Do të përfitorni nga disa ndryshime në punë. Sa i përket jetës në çift, do të bëni disa biseda shumë të këndshme me njëri-tjetrit.

DEMI

Bëni kujdes me sjelljen tuaj pasi mund të përfshihen shumë thjesht në një konflikt. Shmangni personat që ju inatosin dhe përpiguni të relaksoheni. Të afërmit ka gjasa t'ju kënaqin me dhurata.

BINJAKET

Bëni kujdes me dietën ushqimore dhe me ato çfarë konsumoni. Do të keni shpenzime, të cilat nuk i kishit menduar, pasi do të shlyeni disa detyrime të prapambetura. Mos bëni asnjë premim derisa të jeni të bindur se mund ta realizoni.

GAFORJA

Mund të kaloni një mbrëmje të mrekullueshme me bashkëshortin/bashkëshortin tuaj. Partneri/partnerja juaj do të tregohet shumë mbështetës ndaj jush sot. Ka gjasa që një projekt, të cilin keni kohë që prisni të realizohet, të jetë drejt hapit të fundit.

LUANI

Do të kaloni momente të paharueshme me miqtë tuaj. Shmangni tendencën për të shpenzuar gjithçka çfarë keni fituar. Mos e zhgënjoni partnerin/partneren tuaj, pasi mund të pendoheni më pas. Sot do të merrni komplimente për performancën tuaj në punë.

VIRGJERESHA

Do të ndiheni shumë mirë si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para, por bëni kujdes të mos kaloni buxhetin tuaj. Do të përballeni me disa vështirësi në familje, por përpiguni të shmangni situatat e tensionuara.

PESHORJA

Frika mund t'ju shkatërojë lumturinë. Duhet të kuptoni se kjo do të jetë produkt i mendimeve dhe imagjinatës suaj. Të ardhurat financiare do të jenë të mira, por do ta keni të vështirë të kurseni. Përpiguni të ndihmoni të tjerët, por mos u përfshini në çështje që nuk i takojnë.

AKREPI

Kushtojni më shumë kohë vetes suaj, mbi të gjitha gjërat më shumë kohë për tu relaksuar. Ka gjasa që një miku juaj të përfitojë prej jush, nëse e ekzagjeroni me bujarinë. Fjala juaj do të dëgohet në punë. Sot do të bisedoni qetësisht me partnerin/partneren tuaj.

SHIGJETARI

Do të kryeni disa aktivitete sportive, të cilat do t'ju mbajnë në formë fizikisht. Është dita e duhur për të biseduar me persona që i takoni rrallë. Bëni mirë të përfshihen në programe afat-shkurtra, të cilat do t'ju vlejnjë për profesionin tuaj.

BRICJAPI

Takimi me një mik të vjetër do t'ju ndriçojë ditën. Bëni kujdes pasi mund të bëni biseda të dashura me personin e gabuar. Do të jeni në qendër të vëmendjes dhe do të vijnjë mjaft vlerësimë ndaj jush.

UJORI

Kontrolloni emocionet, pasi gëzimi i tepërt mund t'ju sjellë probleme. Shmangni personat që iu afrohen për interes. Mos neglizhoni përgjegjësitë familjare. Dikush mund t'ju bëjë një surprizë shumë të veçantë. Do të vlerësoheni gjatë ditës për punën tuaj.

PESHQIT

Hiqni dorë nga duhani, pasi do të ndiheni shumë mirë për këtë. Gjendja juaj financiare do të përmirësohet, pasi do t'ju shlyejnë disa borxhe. Miqtë do t'ju ndriçojnë mbrëmjen, teksa do të organizojnë diçka mjaft interesante.

Mbrojtësi dhe kapiteni i kombëtares shqiptare të futbollit, Mërgim Mavraj foli në konferencë për shtyp para ndeshjes kundër Izraelit. Në fjalën e tij, kapiteni i kombëtares kuqezi tha: "Përgjegjësia është e çdo futbollisti në fushë. Goli që pësuam në Izrael, i pari, ishte gabim, pasi nuk e treguam veten të aftë në atë moment. Trajneri ka të drejtë. Kjo na ndikoi ndeshjen e fundit.



Mavraj: Kemi pësuar gola për fajin tonë, të përmirësohemi

Nëse përmirësohemi në këtë pjesë, besoj se kemi gjasa të ia dalim. Shumë e vështirë të kemi një recetë se si mbrohesh porta më mirë. Duhet të shmangim gabimet individuale, sepse na kushtojnë pikë. Nuk kemi pasur edhe fatin me vete. Në të kaluarën kemi treguar veten në

mbrojtje. Individualisht duhet të bëjmë më shumë. Duhet vëmendje e jashtëzakonshme në ndeshje. Duhet të jemi të përgjendur në momentet e duhura. Në këto ndeshje të rëndësishme, goditjet standarde kanë fituar shumë vlerë. Stërvitja gjatë javës është tjetër gjë në

krahësim me ndeshjet. Do të përqijemi të përmirësohemi. Kur jemi në stadium me 40 apo 50 mijë spektatorë, nuk mund të themi që një lojtar, ose kapiteni apo lideri kanë gabim. Nuk ka dallim kush është kapiteni. 11-të ushtarë jemi në fushë. Nuk jam unë i vetmi, jemi të gjithë për një

dëshirë e qëllim për të mos pësuar. Nuk është garanci që po nuk fole nuk do ta pësosh. Duhet ndihma e të gjithëve. Nuk mund të garantojmë fitoren. Për të fituar në këto nivele, duhet të mbrohesh maksimalisht, por me dëshirë dhe vullnet të shënojme. Të gjithë të mbrohemi dhe të gjithë të fitojmë. Shanset rriten kështu. Besojmë te fitorja? Nëse nuk do të besonim nuk do të luanim fare," deklaroi Mavraj në konferencën për shtyp

Liga e Kombeve, Shqipëria luan shanset e fundit ndaj Skocisë në "Loro Boriçi" të Shkodrës

Panuçi: Vuaj brenda meje këtë situatë, duhet të fitojmë

Italiani pranon se Shqipëria i ka komplikuar vetë gjërat

Jeton Selimi

Kristian Panuçi ka deklaruar në konferencën e fundit për shtyp në prag të takimit kundër Skocisë në stadiumin "Loro Boriçi" të Shkodrës, se Shqipëria do të futet në fushën e lojës për ta fituar këtë sfidë, fitore që do të zhbente disi këtë edicion eliminator të Ligës së Kombeve, ku kuqezi është drejtuar nga tekniku italian, kanë zhvilluar një performancë të dobët. Panuçi deklaroi se formacionin do ta përcaktojë vetëm përpara ndeshjes, ndërsa nga lojtarët kryesorë, ai që shqetëson është Eros Grezda, që ka vuajtur pasojat e një dëmtimi. Në konferencën për shtyp i pranishëm ka qenë edhe kapiteni Mavraj, që ka pranuar kritikën e trajnerit ndaj skuadrës dhe ka deklaruar se ndaj Skocisë, Shqipëria ka nevojë për 11 kapitenë në fushën e lojës.

Probleme në mbrojtje, por edhe në sulm. Çfarë ka menduar Panuçi për nesër (sot)?

Ndeshja duhet punuar për të shënuar. Në Izrael kemi pasur raste, pavarësisht finalizimit. Kemi taktika që do të përshtaten me ndeshjen. Shpresojmë në fitore. Që kur kam qenë këtu, i kam inkurajuar lojtarët. Pyetni kapitenin, nuk i kam kërkuar të mbrohen, por gjithmonë me ekuilibër, i kam kërkuar që të luajnë sa më shumë ofensiv, nesër do t'i kërkoj të fitojnë.

A do të jenë të gatshëm Grezda dhe Ndoj?

Grezda është stërvitur gjithë javën, dhe ka kërkuar të luajë. Ndoj mendoj se ka ende disa probleme.

Balaj do të jetë nga minuta e parë, pasi luan në shtëpinë e tij?

Do e shohim nesër (sot), por nëse e vendos marrja pjesë e tifozërisë shkodrane nëse luan ai, atëherë do të jetë



shumë mirë.

Viti 2018 ishte më i keqi për Shqipërinë në 10 vitet e fundit.

Është e vërtetë që është vit i keq. Duhet ta përmbysim situatën, por di që përveç Kosovës dhe Ukrainës, ku ishim pak konkurrues, në ndeshjet e tjera kemi pësuar në goditje standarde. Nuk është një moment pozitiv për ne.

Si mund të fitohet ndaj Skocisë?

Duhet një gol më shumë, kaq.

Keni kritikuar komunikimin në skuadër.

Është e vërtetë, skuadra nuk komunikon shumë. Duhet ta bëjnë më shumë, këtë e dinë edhe lojtarët. Nëse arrijnë ta bëjnë, do të jetë

shumë mirë. Shpresojmë që nesër të shohim çunat që të flasin më shumë, do i ndihmojë shumë me rezultatin.

Si do i zëvendësoni Bashën dhe Hysajn?

Do i ndërroj me 2 lojtarë të tjerë. Formacionin do e shihni nesër (sot) në fushë. Duke shpresuar të mos gabojmë.

Do jetë fat stadiumi "Loro Boriçi"?

Nuk është punë e lehtë, se me Italinë humbëm. Shpresoj që këtë radhë të në sjellë pak fat. **Skocia ka shumë mungesa gjithashtu...**

Ne kemi hedhur në erë një grup, djemtë duhet ta kuptojnë e të ndërgjegjësohen se është puna jonë. Kemi bërë një ndeshje të mirë në Izrael, por kthym me 0 pikë, e

vërtetë që qesh, pro brenda meje jam zjarr, nuk më pëlqen. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm për situatën.

Si është situata në ekip, të vjen keq që skuadra u dorëzua në Izrael?

Situata nuk është e mirë, dhe djemtë e dinë që ka pasur shumë ndryshime. Duhet të ketë shumë vëmendje në ndeshjen që vjen. Në Izrael skuadra nuk u dorëzua, për 90 minuta ndoshta ka bërë ndeshjen më të mirë. Për 90 minuta kemi bërë lojë me cilësi, por nuk arritëm të futim topin në rrjetë. Edhe duhet të mos harrojmë që goli i parë me Skocinë është pozicion jashtë loje, përveç është autogol. Ekipi nuk ka pësuar gol në asnjë aksion loje normal deri tani.

TRAJNERI FRANCEZ

E quajnë "pensionit", Venger tërbohohet me gazetarët

Arsen Venger u largua nga kreu i Arsenalit pas plot 22 vitesh si trajner i "Topçinjve" dhe tashmë po pret oferta nga klubet europiane, pavarësisht se shumë mendojnë se francezi ka mbaruar dhe tashmë duhet të dalë në pension njëherë e mirë. "Unë nuk ndihem ende si pensionist, prandaj jam i acaruar," tha Venger për "Bel Sports". "Unë jam një konkurrent dhe futbollist me mungon. Nuk kam mbaruar. Njerëzit gjithmonë duan t'ju kritikojnë dhe të flasin keq. Po më quajnë pensionist dhe të mbaruar. Por do t'i vërtetoj të gjithëve të kundërtën. Një avantazh që unë kam nga 35 vjet në lojë është të shkëmbej atë që di me njerëz të tjerë dhe nëse nuk e bëni këtë atëherë jeta është e padobishme. Ju nuk duhet të largoheni nga kjo botë pa u përpjekur t'i jepni diçka populit",- u shpreh Venger.



KOMBËTARJA U-21 MPOSHI MALTËN 2-0

Gol dhe penalti e fituar, Hebaj shkëlqen me Shpresat

Shqipëria U-21 mposhti Maltën U-21 me rezultatin 2-0 në takimin miqësor të zhvilluar në "Selman Stërmasi". Një dominim i skuadrës kuqezi që arriti të gjente 2 herë rrugën e rrjetës me anë të Rubin Hebaj dhe mesfushorit të Shkëndijës së Tetovës, Imeri, i cili ktheu në gol penalltin e fituar nga shkodrani i Partizanit. Në pjesën e dytë, rritimi i lojës ra ndeshëm, teksa të 2 trajnerët kryen zëvendësime të shumta, që ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë tek loja. Vlen për t'u përmendur aktivizimi i mesfushorit Esat Mala, i cili tronditi traversën në pjesën e dytë, falë një goditjeje mjesh-tërore. Skuadra mike provoi të shënonte te paktën një gol në fundin e ndeshjes, por hasi rezistencën e portierit Dajsinani që ishte në një formë të mirë.



HABIT PRESIDENTI I MILANIT


Skaroni: Më mirë tre kualifikime në Champions sesa titullin kampion

Presidenti i ri i Milanit, Paolo Skaroni, ndryshe nga pjesa e tifozëve që kërkojnë tituj dhe trofe, është i mendimit se më shumë vlerë kanë 3 kualifikime radhazi në Ligën e Kampionëve dhe këtë e ka zbuluar në një intervistë për mediat italiane. Sakaq, ai ka folur edhe në lidhje me merkaton, duke

pranuar se i pëlqen Ibrahimović, por që nuk ka gjë në dorë ai personalisht. "Në futboll duhet të ngjishësh paralelizëm dy male, ku njëri është sportiv, e tjetri ekonomik. Të dy janë të lidhur me "Fair Play-n financiar". Që të sjellim sërish kampionë të mëdhenj këtu, duhet të shohim nga Amerika dhe Lindja. E

adhuroj Ibrahimoviçin, por nuk vendos unë për transferimet. Juventus është i vetmi ekip që po ecën në rrugën e klubeve angleze dhe duhet marrë shembull. Për mendimin tim, më mirë do të ishte të kualifikohesh 3 herë në Champions sesa të fitosh një kampionat", u shpreh presidenti.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Steiger aktor.
- Mbetet në fund.
- Ustinov i kinemasë.
- Janë në modë.
- Nuk e shqyen Danielin.
- Një as i Milan.
- Çobani aktore e jona.
- I dyti në kapitull.
- Dy asa në dorë.
- Qe njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.
- Croft e Angelina Jolie.
- Një që mbahet për mondan.
- Para De Janeiro-s.
- Gjysmë tandem.
- Kap ndryshe.
- Gjysmë tatimi.
- Union Stutendor Operativ.
- Wallach aktor.
- Pak spionazh.
- Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
- Ai dhe ajo.

- Një Madame e Maupassant.
- Kështu thirrej Ernesto Guevara.
- Fund ditari.
- Pije piratesh.
- Kush e thotë refuzon.
- Të parat në sondazh.
- Një makinë franceze.
- Fillojnë stafetën.
- Nisin nga fillimi.
- Qan te Turandot.
- Fundi i një samurai.
- Umberto qe shkroi Lavjersësi i Foucault.
- Dalë në krye.

VERTIKAL

- Ajo e tretë u quajti Moska.
- Në hyrje të odës.
- Me mea për të penduarin.
- Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshima.
- Jepet për hartim.
- Lindi edhe Cerberin.
- Mbyllin pora.
- Gjysma e ekipit.
- Një inkursion me mig.
- Fillojnë lehtë.
- Eshtë tretës me zorrë.
- Pak tematike.
- Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.
- Eshtë ndalim me pranga.
- Shkroi Këngëtarja tullace.
- Eshtë pikë vaji.
- Ndajën shtetet.
- Kush nuk ka... s'është njoftuar.
- Poetja e Lesbos.
- Kështu shprehet komisarri Rex.
- Fillojnë panikun.
- Një liqen i kripur.
- Inva soprano.
- Inicialet e Altman
- Një fjalë për sipër.
- Të parat në stadium.
- Fillojnë turnin.
- Në hyrje të sokakut.
- Fillojnë nazet


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një pune... paguhet.
- Para Zeppelin në grupin e famshëm.
- Vincenzo, bomber te Roma.
- Kufijtë e pritjes.
- Një Arthur i Edgar Allan Poe.
- Demek s'ka kufij.
- Qe filozofi i shkollës eleatike.
- Nino, kompozitor i famshëm italian.
- Eshtë ai që ka ngrityr krye.
- Finlanda e... finlandezëve.
- Mbledh basketë separatistë.
- Inicialet e Prost.
- Shkroi Cocktail party.
- Titulli i Alex ferguson.
- Stile pa kufij.
- Ishin greket që nuk vinin kurrë.
- Unë dhe ti.
- Hoxha që qe arbitër.

VERTIKAL


- Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordonier.
- Në krye të solistëve.
- Janë poetë si Ungaretti.
- Ylli më i shndritshëm i Demit.
- Janë kopjet si delja Dolly.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Fillojnë muzikën.
- Parafjala e prejardhjes.
- Fernando, bomber i Liverpool.
- Bisha aktore.
- Ishin ushtarë të Kserksit.
- Partia Demokratike.
- Cepat e një ylli.
- Ylli i baletit.
- Pak amoralitet.
- Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
- Italia në Internet.
- Përhapet me frikë.
- Mund të jetë françeskan.
- Dehin pa kufij.
- Eshtë lënda për... rafte.
- Gjysmë sahati.
- Tatum që qe pianist.
- Lloj papagalli.
- Një pikë vaji.
- Artikull spanjol.
- Në krye të socialistëve.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6	9		3					8
	1		5	2				
		7				6	3	1
		5	2	6		1	9	
	3		9		4		7	
	4	2		5	1	8		
4	5	3				7		
				7	8		1	
8				5		2	9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	5	7	4	2	8	1	6	9
2	6	8	3	9	1	4	5	7
9	4	1	5	6	7	8	2	3
1	2	3	9	8	4	5	7	6
4	7	5	1	3	6	9	8	2
6	8	9	2	7	5	3	1	4
5	9	4	6	1	2	7	3	8
7	3	6	8	5	9	2	4	1
8	1	2	7	4	3	6	9	5

Argëtim filozofik

- Mos iu drejto me ton të ashpër ndokujt . Atyre që do ju drejtohesh kështu mund të të përgjigjen në të njëjten mënyrë : plagët janë të dhimbshme ; njëra pas tjetrës do bien mbi ty .
- Duke mbrojtur veten ke mbrojtur tjerët ; duke mbrojtur tjerët ke mbrojtur veten .
- Fjalët kanë fuqinë e të shkatruarit dhe të krijimit ; kur fjalët janë të singerta dhe të këndshme mund të ndryshojnë botën .

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	E	P	O	10	8	13			
4	5	3	5	19	2	4	6	2	11
5	13	6		3	5	11	6	7	3
11	5		12	2	8	6	3	20	13
9		10	6	20	4	2		4	5
5	2		13	13	2	12	2		3
	12	13	10	2	3	5		6	11
2	7		5	1		3	3	12	8
19		2	4	3	6		6	4	2
2	13	3		5	10	6	13	2	
4	1	8	5	3		12	5	11	9
6	11	2	7		8	2		6	11

M	I	K	E	K	M	S			E
E	K	A		R	O	M	A	K	E
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E
	M	A	T	E	M	A	T	I	K
P	A	S	A	N	I	K	T		S
E	K	U		A	N	E	T	A	R
R	E	T	E	B	E	I	R	A	N
I	T	R		B	L	A	K	E	L
M	I	A		R	E	D	E	K	I
E		M	E	T	A	L	E	I	S
T	E	K	E	M	K	U	M	T	
M	O	R	A	V	I	A		M	A

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A
D	I	A	N	A	H	A	N	T	I	K	S
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E
T	I	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N
A	K	E	N	E	T	A	O	R	A	R	E
P	A	U	L	E	N	R	T				
A	K	U	P	A	A	D	D	I	M		
E	T	J	I	T	E	R	I	A	M	A	N
T	E	I	L	G	O	R	D	I	A	N	E
I	N	T	A	R	O	M	A	T	I	T	

FJALËKRYQI (2)

P	A	B	M	E	L	E	R	G	O		
R	K	U	P	A	H	E	M	I	R	A	T
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T
C	I	K	L	I	S	T	E	T			
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E
D	I	K	A	S	T	E	R	E	R	U	E
K	E	N	T	A	N	G	O	P	J	E	V
K	A	T	I	A	S	I	E	S	E		
A	R	N	I	O	L	I	A	I	R		
M	A	S	S	I	M	O	Z	A	N	O	R
A	M	A	N	A	N	N	A	N	N		
T	I	E	R	R	E	N	I	E	L	I	N

Thënie të mençura

- 4-Asgjë e gjallë s'duhet vrrarë , as insekti apo kafsha më e vogël , sepse çdo jetë është e shenjtë .
- 5-Jemi ajo që mendojmë .
- 6-Sa më pak të keni , aq më pak duhet të shqetësoheni .
- 7-Aroma e luleve nuk shkon kundër erës , as i Jaseminit , aroma e të mirëve shkon kundër erës : një njeri i drejtë njihet anë e mbanë .

